

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7549 E hënë 4 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Dje**  
në "Deutsche Welle"  
Do të jem i qetë atëherë kur të mos shohë të lëvizë asnjë Mercedes përgjatë Fifth Avenue në Nju Jork. Nëse është e vërtetë kjo fjali, që sipas qarqeve diplomatike...  
Vijon në faqen 21

Nga HENRIK BÖHME  
**Trump kundër të gjithëve, të gjithë kundër Trumpit?**  


**Reportazhi**  
Ditës  
Ineson Ulmit?- pyeti e burgosura në një kamp përqendrimi nazist, zotërinë përkrah saj gjatë arratisjes përmes Gjermanisë së shkatërruar. A është aty ende, apo...  
Vijon në faqen 20

Nga MONIKA STAJA  
**Drezden, rilindja e një qyteti**



Prokurori i çështjes "Tahiri", më 5 qershor përpara KPK

## Vetingu, sot kalon në 'sitë' prokurorja Anila Leka, zbardhen të ardhurat e pasuria

Deklarimet e bëra për periudhën 2004-2016, ja çfarë verifikoi ILDKPI

Një tjetër prokurorë do të kalojë në 'sitën' e vetingut. Para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të dalë Anila Leka, prokurorë e Prokurorisë së Përgjithshme dhe kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Seanca e KPK-së do të mbahet ditën e sotme, ndërkohë, trupa gjyqësore përbëhet nga Firdes Shuli, Roland Ilia...

Në faqen 8

## SHQYRTIMI I DOSJEVE NE AGJENCINE E TRAJTIMIT TE PRONAVE, DOKUMENTET

# ISH-PRONARET, ATP NDRYSHON PROCEDURAT PER KOMPENSIM

Si procedohet për të aplikuar dhe për t'u ankuar për problematikat e shqyrtimit të dosjes. Pagesa dhe afatet kohore kur do të merrni përgjigje



(Në foto) Foto ilustruese

### REAGON DHE LSI

**PD: Rama po provokon banorët e veriut me taksën e rrugës. Spaho: Harroje, s'do paguajmë**  
Në faqen 2

### SIPERFAQET PERKATESE

**Ndërtimet pa leje, lista e dytë me tapitë për 1 mijë familjet përfituese**  
Në faqen 10-11

### IU ASGJESUAN 2700 BIME

**Parcela me kanabis në Krujë, ja emrat e të arrestuarve, në kërkim edhe të tjerë**  
Në faqen 7

### VENDIMET 1993-2008

**Pronarët në Shkodër, ATP merr në shqyrtim 4400 dosje, procedurat për t'u njohur me ecurinë**  
Në faqen 18-19

### FLET EKSPERTJA



**Ndiha familjare nga Italia për emigrantët shqiptarë, Aliq: Ja kategoritë përfituese**  
Në faqen 9

Gastrohepatologia Albana Duni: Si të parandaloni kancerin e stomakut me dietë

## Ylli Merja: Si të kuroni gjëndrën tiroide

Mjeku popullor: Përbërësit e çajit çudibërës, efektet e menjëhershme

Nga VOLTIZA DURO  
Struma ose gusha quhet rritja dhe zhvillimi i tiroides, e cila mund të jetë difuze ose e lokalizuar në formën e nodujve. Shenjat shfaqen te pacienti në varësi të llojit të strumës. Struma difuze homogjene ku përf-



shihet sëmundja e basedovit, që prek gratë e karakterizohet nga sekretimi i shtuar i hormoneve tiroidiene T3 dhe T4. Kjo sëmundje është me natyrë autoimune dhe klinikisht jep disa shenja si: zmadhim i kokërdhokut të syrit (egzoftalmi)...

Suplement

# RRUGA E KOMBIT TAKSA

Tarifa do të jetë 100 - 200 lekë. Kryeministri e prezanton javën e ardhshme

## Rruga e Kombit, Spaho-Ramës: Harroje, shqiptarët s'do paguajnë

### Vasili thirrje qytetarëve: Refuzojeni taksën

Valentina Madani

**D**emokratët denon- cuan dje përpjekjet e qeverisë për rivendosjen e mundshme të taksës në Rrugën e Kombit. Rivendosja e taksës në Rrugën e Kombit cilësohet nga PD-ja si një provokim të rrallës ndaj këtyre banorëve. Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho shprehet se kryeministri Rama po provokon sërish qytetarët. Mes të tjerash demokracia tha se Rama i ka bërë gabim llogaritë. "Në media po lexoj që kryeministri ka vendosur të provojë edhe një herë taksën e Rrugës së Kombit. Kryeministri i pacipë një muaj pasi u tha më fal banorëve të Kukësit, Hasit dhe Tropojës po i provokon sërish. Nuk mjafton që katër prej tyre i mban padrejtësisht në burg nëpërmjet veglave të tij në gjyqësor, por duhet që t'i provokojë me rishfaqjen e taksës. Për Ramën nuk ka rëndësi që banorët e këtyre zonave janë më të varfrit e Shqipërisë. Për të ka rëndësi të mbushë xhepat me milionë e gjobës korruptive që ka vendosur për këtë akt të paprecedent antipopullor dhe antikombëtar. I ke bërë gabim llogaritë Edi Rama. Nuk paske vënë mend nga hera e parë. Kur njerëzit humbin çdo shpresë nuk ka forcë dhe arrogancë që t'i ndalë. Harroje që kuksianët apo çdo shqiptar të paguajnë taksë për atë rrugë dhe kanë të drejtë të vepronjë kështu. Kij kujdes se këtë radhë do të vijmë deri në Tiranë. De nuk do të jenë vetëm...  
**THIRRJA**  
Edhe kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së Petrit Vasili u bëri dje thirrje qytetarëve të refuzojnë taksën e Rrugës së Kombit. Vasili pohoi se Rama duhet t'i japë fund këtij qëndrimi dhe se duhet t'ua kthejë qytetarëve rrugën. Ndaj teksta pritet që brenda pak ditësh të rivendoset taksa e kalimit në Rrugën e Kombit, kreu

i grupit parlamentar të Lëvizjes Socialiste për Integrim, Petrit Vasili bën thirrje për ta refuzuar atë. "Prapë do venë taksë në rrugën e Kombit këta? Refuzojeni taksën e Rrugës së Kombit! Kryeministri u vetëdeklarua fajtor për re-

voltën shumë të drejtë, që ndodhi, kur ai vuri taksën në Rrugën e Kombit. Dhjetëra kuksianë u arrestuan dhe disa janë akoma në burg. Kryeministri peng i interesave dhe përfitimëve të errëta përsëri po përgatit taksën, që do të verë sërish

në rrugën e Kombit. Paguajnë shqiptarët çmimin më të lartë të karburantit në gjithë Ballkanin dhe Europën bashkë, sepse brenda tij janë qindra miliona euro për mirëmbajtjen e rrugëve. Këto qindra miliona euro, që u marr kryeministri në çdo litër karburant, nuk i përdor për rrugët, por i grabit për të mbjellë palma të thara buzë rruge, për zyra, tualete zyrash, ekspozita pikturesh idiothe, sokakë qytetesh, që i shtron dhe i shqep dhjetëra herë, për koncesione etj. Menuja e grabitjes dhe e shpërdorimit është pa fund. T'i japë fund këtij maskarallëku kryeministri me paratë e mirëmbajtjes së rrugëve dhe t'ua kthejë ato përsëri rrugëve. Deri atëherë: krahoni taksën e Rrugës së Kombit", - shprehet z. Vasili.



Kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho

### "Ekonomia po shkon drejt një krize"

## Tabaku: Realiteti dhe propaganda e Ramës, në maj 2018 u mbyllën 1016 biznese

**D**eputetja e PD-së, Jori da Tabaku denoncoi dje se realiteti ekonomik në Shqipëri është shumë i dhimbshëm, ndryshe nga ajo që kryeministri Rama propagandon në televizionin e tij personal, ERTV. Tabaku i referohet të dhënave zyrtare dhe shprehet se në 5 muajt e parë të vitit janë mbyllur 5848 biznese, të cilat pritet të lënë pa punë dhe pa të ardhura shumë të rinj, por edhe familjarë. Deputetja e PD Jorida Tabaku ka bërë një krahasim, një përballje midis asaj që quhet realiteti shqiptar dhe propagandës qeveritare. Tabaku shpjegon me shifra sesi realiteti në ekonomi nuk përputhet me propagandën e Ramës. Sipas saj nga të dhënat zyrtare, në Maj 2018 mbyllën aktivitetin 1016 bi-



znesë. "Realiteti dhe propaganda e Ramës. Realiteti: Të dhënat zyrtare tregojnë se në maj 2018 mbyllën aktivitetin 1016 biznese. Në 5 muaj, janar-maj 2018, 5848 biznese mbyllën qepenat. Çdo biznes që mbyllet do të thotë rroga që nuk paguhen më, kryefamiljarë dhe të rinj që mbeten pa punë, më pak të ardhura dhe më shumë varfëri për familjet shqiptare. Të dhënat zyr-

**“PËRBALLJA**  
Deputetja e PD Jorida Tabaku bën një krahasim, një përballje midis asaj që quhet realiteti shqiptar dhe propagandës qeveritare. Tabaku shpjegon me shifra sesi realiteti në ekonomi nuk përputhet me propagandën e Ramës. Sipas saj nga të dhënat zyrtare, në Maj 2018 mbyllën aktivitetin 1016 biznese. tare të kreditimit të ekonomisë konfirmojnë krizën ekonomike! Ky është muaji i pestë radhazi që kreditimi ulët. Kredia për bizneset në Prill 2018 rezultoi 17 milionë dollarë më pak sesa marsi dhe 80 milionë dollarë më pak se prilli 2017. Propaganda: Për propagandën shkoni se si Edi Rama gjenjen live në ERTV", - shkruan zj.Tabaku.



Protesta në Rrugën e Kombit

### PREZANTIMI

Pritet që javën e ardhme kryeministri Rama të prezantojë vetë mënyrën e re të tarifimit dhe rishikimit të taksës kryesisht për banorët e zonës. Aplikimi i taksës nuk do të nisë menjëherë, por do të ketë një periudhë informimi për banorët me qëllim sqarimin sa më mirë të funksionimit të tarifimit.

### TARIFA E TAKSES

Tarifa në Rrugën e Kombit për banorët e Kukësit dhe zonave përreth pritet të jetë 100 lekë për një kalim ose 200 lekë vajtje ardhje. Ndonëse fillimisht u përfol se taksa e kalimit për banorët dhe përdoruesit e shpeshtë do të jetë 1.5 euro, qeveria duket se ka vendosur të miratojë një nivel më të ulët duke e bërë pagesën 100 lekë për kalim.

### "LLOGARIDHËNIA"

## Bushati në Shkodër: Do i japim zgjidhje përfundimtare përmbytjeve

**T**uri i llogaridhënies "Puna për Shqipërinë që duam", në qarkun e Shkodrës u ndal këtë herë në Dajç. Në këtë bashkëbisedim me banorët të zonës ishin drejtuesi politik i qarkut, ministri Ditmir Bushati, zëvendësministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Mira Rakacolli dhe zëvendësministri i Bujqësisë Dhimo Koto. Problematikat e banorëve të zonës së Nënshkodrës janë përmbytjet, sistemi i kanalizimeve, shëndetësia dhe punësimi. Në fjalën e tij, ministri Bushati theksoi se qeveria po punon për implementimin e një zgjidhje përfundimtare për sa i përket përmbytjeve në këtë zonë. Ministri Bushati theksoi se është shumë e nevojshme që të komunikohet me banorët për ecurinë e procesit dhe hapat konkretë të ndërhyrjeve. Nga ana e tij, zëvendësministri i Bujqësisë Dhimo Kote shtoi se po punohet për pastrimin e Bunës me drag dhe derdhjen në det, çka mendohet se do zgjidhë përmbytjet në këtë zonë. Qendra Shëndetësore në Dajç është një nga më të mira të Shqipërisë - vijoi zv.ministria Rakacolli, ndërsa shtoi se banorët e kësaj zone janë shumë të kujdesshëm në kryerjen e check-up.





**Lufta kundër terrorizmit, konferenca e Jordanisë zhvendoset në Tiranë**

Tirana sot do të jetë në gatisje për të marrë pjesë në konferencën e Jordanisë për të marrë pjesë në bisedimet dhe takimet kundër terrorizmit, por zhvendoset në Tiranë nga Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama në kuadër të Aqaba Meeting, ose Takimet e Akabës, një iniciativë e Mbretit të Jordanisë, Abdullah, që për herë të parë organizohet jashtë vendit të tij që prej themelimit në vitin 2015. Vetë Mbreti Abdullah i Jordanisë ishte parashikuar që të vinte në Tiranë për të marrë pjesë në bisedimet dhe takimet kundër terrorizmit, por zhvendoset në Tiranë nga Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama në kuadër të Aqaba Meeting, ose Takimet e Akabës, një iniciativë e Mbretit të Jordanisë, Abdullah, që për herë të parë organizohet jashtë vendit të tij që prej themelimit në vitin 2015. Vetë Mbreti Abdullah i Jordanisë ishte parashikuar që të vinte në Tiranë për të marrë pjesë në bisedimet dhe takimet kundër terrorizmit, por zhvendoset në Tiranë nga Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama në kuadër të Aqaba Meeting, ose Takimet e Akabës, një iniciativë e Mbretit të Jordanisë, Abdullah, që për herë të parë organizohet jashtë vendit të tij që prej themelimit në vitin 2015.

Kryeministri Edi Rama shpreh bindjen e plotë se Shqipëria e meriton hapjen e negociatave me Bashkimin Evropian duke përmendur se pikërisht për këtë gjë luftoi fort në samitin e Sofjes. Kryeministri Edi Rama vlerëson mbështetjen e Austrisë në çdo moment kyç që ka kaluar Shqipëria duke e konsideruar si një partner të fortë në rrugën drejt integritetit në BE. Gjatë një interviste për ARD, Rama deklaroi se "Austria është prej shumë kohësh një mbështetës i Ballkanit Perëndimor dhe ka qenë gjithnjë besnike dhe miqësore me ne. Si dhe është një prej mbështetësve tanë të mëdhenj". I pyetur mbi rezultatin e samitit të fundit të Ballkanit Perëndimor në Sofje dhe, nëse priste më shumë rezultate, Rama shprehet për ARD se: "Jo nuk prisja, sepse e dija çfarë kishim bërë dhe sa progres mund të bënim, kështu që e dija se nuk ishte koha për të kërkuar asgjë të tillë, por se ishte një çast për të vazhduar dhe luftuar, pra ishte një takim i mirë, sepse munda të luftoj". Për sa i përket hapjes së negociatave, kreu i ekzekutivit thekson se "Shqipëria e meriton hapjen e negociatave pasi kemi marrë një rekomandim shumë të qartë nga komisioni". "Nuk e kuptoj se si kjo makineri që kushton miliarda për të hartuar raportet të intërsishme mund të sfidojë objektivat e veta. Sigurisht, e di që ka vende anëtare që kanë probleme të brendshme, por besoj fuqishëm në shpirtin e Europës. Dhe në shpirtin e Europës ka një qasje strikte dhe të drejtë, kështu që deri tani qasja ka qenë strikte dhe padrejtë", deklaron kryeministri. Për sa i përket migracionit legal që kalonë kufirin nga Greqia drejt Shqipërisë dhe më pas drejt Europës Qendrore, Rama shprehet se "kemi një raport me vitin e kaluar. Këto shifra nuk janë shqetësuese për gjithë Europën, por mund të bëhen shqetësuese. Pra, ne nuk duhet të bëjmë atë që është bërë gabim në vitin 2015. Duhet të jemi parandalues dhe proaktiv për këtë arsye fola, gjithashtu, edhe me kancelarin këtu për të ngritur një bashkëpunim që të sigurohem që gabimi i vitit 2015 të mos përsëritet". I pyetur nëse duhet të ngrihen një barrierë në kufirin me Greqinë në të ardhmen, kryeministri deklaroi se "nuk besoj në barrierat fizike, besoj në barrierën e bashkëpunimit mes shteteve dhe njerëzve. Pra, nëse kjo barrierë është e ndërthurur mirë, atëherë çdo gjë është shumë mirë dhe nëse është e bërë siç duhet jo vetëm mbron kufijtë, por respekton edhe dinjitetin e njerëzve".

Kryeministri: Ka një qasje strikte dhe të drejtë, shprej të mos jetë e padrejtë

# Hapja e negociatave, Rama: Besoj në "shpirtin" e Europës

"Në Samitin e Sofjes munda të luftoj për këtë gjë"



Kryeministri Edi Rama

**MBESHTETJA**

"Austria është prej shumë kohësh një mbështetës i Ballkanit Perëndimor dhe ka qenë gjithnjë besnike dhe miqësore me ne. Si dhe është një prej mbështetësve tanë të mëdhenj". I pyetur mbi rezultatin e samitit të fundit të Ballkanit Perëndimor në Sofje dhe, nëse priste më shumë rezultate".

**DEKLARATA**

"Sigurisht, e di që ka vende anëtare që kanë probleme të brendshme, por besoj fuqishëm në shpirtin e Europës. Dhe në shpirtin e Europës ka një qasje strikte dhe të drejtë, kështu që deri tani qasja ka qenë strikte dhe shprej të mos jetë e padrejtë", -tha z.Rama.



## Çelja e negociatave me BE, Shqipëria lobon për të bindur Holandën

Hapja e negociatave është objektivi kryesor i Shqipërisë, teksa pritet vendimi i 28 vendeve anëtare të BE në mbledhjen e Këshillit të Ministrave në 28 qershor. Holanda është një shtet me të cilin Shqipëria po bashkëpunon në mënyrë të frytshme sa i përket çështjeve të drejtësisë, sigurisë, ekonomisë, ambasadorja e Shqipërisë në Holandë, Adia Sakiqi u përgjigj interesimit të ATSH-së në lidhje me ecurinë e procesit të çeljes së negociatave dhe qëndrimin të Holandës. "Në mënyrë të vazhdueshme janë zhvilluar takime me ministrin e Jashtme holandez, si dhe janë mbajtur kontakte me përfaqësuesit e medias holandeze". Deklaroi ambasadorja Sakiqi. Gjithashtu, në këtë kuadër, ambasadorja thekson se, "kanë zhvilluar takime në Holandë me aktorë të ndryshëm të politikës ministri i Jashtëm i Shqipërisë, ministri i Bujqësisë, Ministria e Drejtësisë, Ministri i Brendshëm, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, zv/ ministrit e Brendshëm dhe ata të Drejtësisë". Gjithashtu, shton më tej Sakiqi, në Ministrinë e Jashtme të Holandës janë zhvilluar konsultime diplomatike bilaterale. "Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër krimit të organizuar midis autoriteteve policore të dy vendeve është rritur në mënyrë të ndjeshme dhe përpara një jave është firmosur "Letër of Intent" me Ministrinë për Sigurinë dhe Drejtësinë të Holandës", evidenton diplomatja shqiptare. Një punë intensive është bërë edhe sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile holandeze e cila ka një zë të fuqishëm në vendimmarrjet politike.



"Ballkani Perëndimor oborri i brendshëm i Europës"

## Ministri gjerman: Çelja e negociatave do ishte inkurajuese për reformat

Michael Roth, ministri i Shtetit për Çështjet Europiane në Ministrinë e Jashtme Federale, gjatë një vizite në Shqipëri para disa javësh pati rikonfirmuar mbështetjen e Gjermanisë ndaj Shqipërisë në procesin e reformave. Roth publikoi dje një artikull në gazetën FAZ ku shprehet se Ballkani Perëndimor, pjesë e të cilit është edhe Shqipëria, është oborri i brendshëm i Europës, duke dhënë kështu edhe një herë një sinjal pozitiv për vendin tonë mbi hapjen e negociatave. "Shqipëria ka ndërmarrë një reformë të thellë e të pashembullt në drejtësi. Nëse do ia dalë me sukses, vendi do avancojë shumë përpara, po kështu edhe në luftën kundër krimit të organizuar. Maqedonia është përmirësuar dukshëm me marrëdhëniet me fqinjët, pas vitesh stanjacioni, protestash në rrugë dhe së fundmi një ndryshimi paqësor të qeverisë. Ajo po punon me vull për agjendën e reformave. Në të dyja këto shtete qeveritë e orientuara nga reformat gjenden para sulmit të ashpër të opozitës. Për sundimtarët, dhe ndoshta për disa qytetarë e qytetare, pa dyshim do të ishte më e lehtë të vendoseshin në sistemin e patronazhit dhe korrupsionit, sesa të luftonin për tejkalimin e tij", -thuhet në artikull.

## DIKTATURA DENONCIMI

Ish-kryeministri nxjerr shifrat: Ku i punësoi Rama 10 mijë shqiptarë në 4 muaj

# Berisha: Rikthehen fatosat e Enverit me shallin e kuq në qafë

Publikon videon e drejtorit të Arsimit në Berat

Valentina Madani

Ish-kryeministri Sali Berisha denoncoi dje për rikthimin edhe njëherë të fatosave të Enverit. Z.Berisha postoi një video ku shkruan se drejtori i Drejtorisë Arsimore në Berat, feston 1 Qershorin me fatosat e Enverit me shami të kuqe në qafë. Në videon në fjalë shihet se si një grup fëmijësh të vegjël kërcëjnë me rastin e 1 Qershorit, ndërkohë që në mes të tyre është kreu i drejtorisë Arsimore në Berat, Selman Hodaj. Ish-lideri i PD-së kujton me ironi festat që bëheshin në kohën e regjimit komunist, ndërsa shkruan se "janë kthyer fatosat e Enverit". "Rikthehen fatosat e Enverit! Drejtori i drejtorisë arsimore te Beratit feston 1 qershorin me fatosat e Enverit me shami të kuqe në qafë!", shkruan Berisha në "Fb" shoqëruar me videon e qytetarit dixhital.

### PUNËSIMI

Duke ironizuar deklaratat e kryeministrit Edi Rama, ish-kryeministri Sali Berisha në një postim në rrjetet sociale renditi dje shifrat e shqiptarëve që janë punësuar në 4 muaj, por këta janë të gjithë refugjatë sipas ish-liderit të PD. "Ja dhe 10 mijë vendet e punës që krijoi Piktori dështak në 4 muaj! Të dashur miq, Noriega deklaroi se në katër muajt që kaluan ka punësuar 10,000 shqiptarë. Unë e di se ju nuk e besoni pasi ai në çdo fjalë nxjerr rrena taze, por kësaj herë ai tha të vërtetën dhe konkretisht ja vendet ku i punësoi 10 mijë vetë në 4 muaj: 7400 në punësuan refugjatë në Francë. Shqipëria këtë vit zë vendin e parë në botë për punësimin refugjatë në Francë të qytetarëve të saj! 2000 u punësuan refugjatë në Gjermani. 1500 u punësuan në Mbretërinë e Bashkuar. 800 u punësuan në Vendet e Ulta. 700 në Suedi dhe Norvegji dhe 2000 të tjerë në SHBA, Kanada, Katar etj. Pra miq, mund themi me të madhe: Si-hariq se plasi puna!! Dhe kur plasin të mirat hapura derën! Piktori dështak jo që nuk gënjeu, por nga frika se ju



Ish-kryeministri Sali Berisha

### MILIONE

Denoncimi "Rikthehen fatosat e Enverit! Drejtori i Drejtorisë Arsimore të Beratit feston 1 qershorin me fatosat e Enverit me shami të kuqe në qafë!", shkruan Berisha në 'Facebook', shoqëruar me videon përkatëse.



Pjesë nga videonja e publikuar nga ish-kryeministri Sali Berisha

## Spitalet, Tritan Shehu - Edi Ramës: Lëri shakatë

Pas turit të llogaridhënies së kryeministrit Edi Rama në Cërrik, reagoi dje deputeti i PD-së Tritan Shehu. Pas deklaratës së z.Rama se Shqipëria ka shumë spitale, Shehu i përgjigjet me shifra: "Vendi ynë ka vetëm 2,2 shtretër spitalor për 1000 banorë-mesatarja europiane është 4. Kemi 1,1 mjekë për 1000 banorë-mesatarja europiane është 4,5. Janë aktive te ne rreth 200 specialitete mjekësore, në vendet europiane janë rreth 2000 të tilla".



## "Robotizëm ekstrem", akuza kolegëve me dokumente

# Denoncimi i Boçit: PS kaloi ligjin me 279 nene në 15 minuta

Deputeti i PD, Luçiano Boçi denoncoi dje përmes dokumenteve parlamentar kolegët e mazhorancës në Komisionin e Medias. Boçi kujton se jashtë lloj diskutimi dhe konsultimi, një ligj me 279 nene është kaluar në mënyrë të rrefshme nga deputetët e PS në vetëm 15 minuta. "Kulmi i shpejtësisë. Nuk është arritur as nga Ferrari, as Lamborghini, as nga Maserati...Jo! Kulmin e shpejtësisë e ka kapur...Komisioni ynë parlamentar i Edukimit, me vetëm deputetët e mazhorancës. A e mendoni? Vetëm për 15 minuta ka miratuar nen për nen, jo pak, por plot 279 nene të ligjit më të gjatë të

## Nenet

Vetëm për 15 minuta ka miratuar nen për nen, jo pak, por plot 279 nene të ligjit më të gjatë të sjellë ndonjëherë, atij të "Trashëgimisë kulturore". Megjithatë për këtë ligj u bënë seanca dëgjimore maratonë, me mendime nga më të ndryshme specialistësh, asgjë nuk u pasqyrua. Menti për diskutim dhe

ndryshime të domosdoshme është pikërisht kjo fazë e diskutimit. Por robotizimi ekstrem dhe bindja e verbër e deputetëve ka kapur majat. Siç shihet nga proces-verbali i mbledhjes deputetët thjeshtë ngrenë dorën pas

Nene 1
Nene 2
Nene 3
Nene 4
Nene 5
Nene 6
Nene 7
Nene 8
Nene 9
Nene 10
Nene 11
Nene 12
Nene 13
Nene 14
Nene 15
Nene 16
Nene 17
Nene 18
Nene 19
Nene 20
Nene 21
Nene 22
Nene 23
Nene 24
Nene 25
Nene 26
Nene 27
Nene 28
Nene 29
Nene 30
Nene 31
Nene 32
Nene 33
Nene 34
Nene 35
Nene 36
Nene 37
Nene 38
Nene 39
Nene 40
Nene 41
Nene 42
Nene 43
Nene 44
Nene 45
Nene 46
Nene 47
Nene 48
Nene 49
Nene 50
Nene 51
Nene 52
Nene 53
Nene 54
Nene 55
Nene 56
Nene 57
Nene 58
Nene 59
Nene 60
Nene 61
Nene 62
Nene 63
Nene 64
Nene 65
Nene 66
Nene 67
Nene 68
Nene 69
Nene 70
Nene 71
Nene 72
Nene 73
Nene 74
Nene 75
Nene 76
Nene 77
Nene 78
Nene 79
Nene 80
Nene 81
Nene 82
Nene 83
Nene 84
Nene 85
Nene 86
Nene 87
Nene 88
Nene 89
Nene 90
Nene 91
Nene 92
Nene 93
Nene 94
Nene 95
Nene 96
Nene 97
Nene 98
Nene 99
Nene 100
Nene 101
Nene 102
Nene 103
Nene 104
Nene 105
Nene 106
Nene 107
Nene 108
Nene 109
Nene 110
Nene 111
Nene 112
Nene 113
Nene 114
Nene 115
Nene 116
Nene 117
Nene 118
Nene 119
Nene 120
Nene 121
Nene 122
Nene 123
Nene 124
Nene 125
Nene 126
Nene 127
Nene 128
Nene 129
Nene 130
Nene 131
Nene 132
Nene 133
Nene 134
Nene 135
Nene 136
Nene 137
Nene 138
Nene 139
Nene 140
Nene 141
Nene 142
Nene 143
Nene 144
Nene 145
Nene 146
Nene 147
Nene 148
Nene 149
Nene 150
Nene 151
Nene 152
Nene 153
Nene 154
Nene 155
Nene 156
Nene 157
Nene 158
Nene 159
Nene 160
Nene 161
Nene 162
Nene 163
Nene 164
Nene 165
Nene 166
Nene 167
Nene 168
Nene 169
Nene 170
Nene 171
Nene 172
Nene 173
Nene 174
Nene 175
Nene 176
Nene 177
Nene 178
Nene 179
Nene 180
Nene 181
Nene 182
Nene 183
Nene 184
Nene 185
Nene 186
Nene 187
Nene 188
Nene 189
Nene 190
Nene 191
Nene 192
Nene 193
Nene 194
Nene 195
Nene 196
Nene 197
Nene 198
Nene 199
Nene 200
Nene 201
Nene 202
Nene 203
Nene 204
Nene 205
Nene 206
Nene 207
Nene 208
Nene 209
Nene 210
Nene 211
Nene 212
Nene 213
Nene 214
Nene 215
Nene 216
Nene 217
Nene 218
Nene 219
Nene 220
Nene 221
Nene 222
Nene 223
Nene 224
Nene 225
Nene 226
Nene 227
Nene 228
Nene 229
Nene 230
Nene 231
Nene 232
Nene 233
Nene 234
Nene 235
Nene 236
Nene 237
Nene 238
Nene 239
Nene 240
Nene 241
Nene 242
Nene 243
Nene 244
Nene 245
Nene 246
Nene 247
Nene 248
Nene 249
Nene 250
Nene 251
Nene 252
Nene 253
Nene 254
Nene 255
Nene 256
Nene 257
Nene 258
Nene 259
Nene 260
Nene 261
Nene 262
Nene 263
Nene 264
Nene 265
Nene 266
Nene 267
Nene 268
Nene 269
Nene 270
Nene 271
Nene 272
Nene 273
Nene 274
Nene 275
Nene 276
Nene 277
Nene 278
Nene 279

### MIRATIMI



Deputeti i PD, Luçiano Boçi

pyetjes: Jeni dakort? Normal askush nuk ka guxuar të dalë kundër "vijës". Nuk pyeten siç e lyp rregullorja: Pro? Kundër? Abstenim? E më pas të bëhen korigjime apo rregullime. Lodhen pra! Madje në nene të caktuara as nuk

u merret fare dora e dakordësisë. Thjesht kalohet ne nenet suksesive. Ky pra është serioziteti zero i kësaj mazhorance në ligjet që servit, që po kap kulme të papara!,-shkruan z.Boçi.

nuk do ta besoni foli vetëm për një pjesë të shqiptarëve të punësuar si refugjatë katër muajt e parë të këtij viti! Ndaj dhe së bashku le t'i themi:

Aferim more Edvin aferim, puna jote s'ka mbarim, s'ka mbarim!", shprehet z.Berisha. Po dje ish-kryeministri Sali Berisha publikoi në faqen

e tij të 'Facebook'-ut detajet nga vizita e kryeministrit Rama dy ditë më parë në Belsh. Berisha, bazuar tek dëshmia e qytetarit dixhital,

zbardhi momentet ku duket se si një punonjës vijëzon vendet e parkimit. "Doktor, një ditë para ardhjes së kryenarkos në Belsh",-shprehet

Berisha. Kryeministri Rama ishte i pranishëm në Belsh, bashkë me përfaqësues të kabinetit të tij, në kuadër të turit të llogaridhënies.

Shqyrtimi i dosjeve në Agjencinë e Trajtit të Pronave, dokumentet pranohen në e-Albania

# Pronarët, agjencia ndryshon procedurat për kompensim

## Kostoja e aplikimit 3 mijë lekë, afati 30 ditë

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtit të Pronave ndryshon procedurat për shqyrtimin e dosjes së ish-pronarëve. Përmes një njoftimi zyrtar ATP bën të ditur se ka kaluar në portalin e-Albania aplikimin për ankesë dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës, si dhe aplikimin për kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes. Me anë të dërgimit online të kërkesës për marrjen e informacionit, vetë Agjencia e Pronave, përmes personave përgjegjës, kryen shqyrtimin e kërkesës bashkë me dokumentacionin shoqërues. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, ajo trajtohet nga specialistët dhe brenda 30 ditësh qytetarit të interesuar i kthehet përgjigja online përmes emailit si dhe te seksioni "Hapësira ime" në portalin e-Albania. Në rast se përgjigja kërkohet edhe në letër, atëherë qytetari duhet të paraqitet fizikisht pranë sporteve të ATP-së. Edhe kur aplikimi për kërkesën nuk është sipas rregullave të paracaktuara, sërish njoftimi i qytetarit bëhet me email, duke shmangur çdo lloj keqkuptimi të mundshëm. "Gazeta Shqiptare" zbardh gjithë procedurën që duhet të ndiqet për aplikim si dhe dokumentet që duhet të dorëzohen përmes portalit qeveritar. Kostoja e aplikimit është 3 mijë lekë, ndërsa afati i shqyrtimit të kërkesës vetëm 30 ditë.



Foto ilustruese

### KERKESA

Me anë të dërgimit online të kërkesës për marrjen e informacionit, vetë Agjencia e Pronave, përmes personave përgjegjës, kryen shqyrtimin e kërkesës bashkë me dokumentacionin shoqërues.

## Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes për ish-pronarët

Shërbim elektronik "Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes" u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë online kërkesën për të marrë informacion në lidhje me ecurinë e shqyrtimit të dosjeve të ndjekura nga Agjencia e Trajtit të Pronave(ATP).

Pas dërgimit të aplikimit, specialisti i Zyrës Juridike, pranë ATP-së, bën shqyrtimin e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues nëse ka. Në rastin kur kërkesa është e rregullt, specialisti përpilon përgjigjen për kërkesën e aplikantit dhe ia dërgon me e-mail, si dhe tek "Hapësira ime" në seksionin "Dokumentet e mia" në portalin e-Albania. Nëse

**DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM**

1. Dokument identifikimi; kartë identiteti ose pasaportë biometrike ( i nevojshëm për t'u loguar në portal)
2. Formulari i aplikimit për informim në lidhje me ecurinë e dosjes
3. Dokumentacion shtesë, nëse është e nevojshme

**HAPAT E PROCEDURËS**

1. Logohuni si qytetar në portalin e-Albania
2. Zgjidhni shërbimin "Kërkesë për statusin dhe problematikat e shqyrtimit të dosjes"
3. Plotësoni te dhënat e formularit, duke bashkëngjitur dhe dokumente plotësuese nëse është e nevojshme
4. Klikoni butonin "Dërgo"
5. Specialisti i Zyrës Juridike bën shqyrtimin e aplikimit dhe përpilon përgjigjen duke ia dërguar aplikantit të nënshkruar në mënyrë dixhitale ose me postë në hard copy, në varësi të kërkesës së aplikantit

**Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit 30 ditë**

përgjigja është kërkuar edhe në formatin letër, atëherë ai njoftohet se duhet të paraqitet pranë Agjencisë së Trajtit të Pronave për ta tërhequr atë. Në rastin kur aplikimi nuk është i rregullt dhe nuk pranohet, aplikanti njoftohet për këtë fakt me anë të e-mail.

### DOKUMENTACIONI

1. Kërkesë sipas formularit Tip (për subjektet që depozitojnë kërkesa të reja sipas vendimit të gjykatës për rivendosje në afat);
  2. Kërkesa nënshkruhet nga subjekti i shpronësuar apo nga përfaqësuesi me prokurë;
  3. Mandatpagesë për shqyrtimin e kërkesës (për subjektet që depozitojnë kërkesa të reja);
  4. Dëshmi trashëgimie, në rast se subjekti i shpronësuar ka vdekur;
  5. Dokument identifikimi i subjektit të shpronësuar apo përfaqësuesit me prokurë.
- Dokument ligjor: (një ose më shumë nga të poshtëshënuarit me përjashtim të pikës c):
1. Vërtetim pronësie, i shoqëruar me një kopje të fletës përkatëse të regjistrimit hipotekor lëshuar nga ZVRPP për efekt të kthimit dhe kompensimit të pronës;
  2. Dokumentin kadastral, shoqëruar me një kopje të fletës përkatëse të regjistrimit kadastral nga zyra e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qark;
  3. Vendim gjyqësor i formës së prerë së bashku me hartën e pasurisë të vullosura me vlerën e gjykatës dhe të shoqëruar me akt ekspertim përkatës, në rast se gjatë gjyqimit të çështjes është kryer një i tillë;
  4. Dokument që vërteton shpronësimin, shtetëzimin apo konfiskimin e pronës së subjektit të shpronësuar, sipas akteve ligjore e nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose në çdo mënyrë tjetër të padrejtë që nga data 29.11.1944 ; apo dokumenti për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë të krijuara para datës 7 prill 1939, të cilat janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr. 37, datë 13.01.1945 "Ligja e tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës".
  5. Vendimet e mëparshme të ish-K.K.K.P të

- marra sipas ligjeve: nr. 7698, dt.15.04.1993, ose nr. 7699, dt. 21.04.1993, dhe nr. 9235, dt. 29.07.2004, të cilat janë marre para hyrjes në fuqi të ligjit 9583, dt.17.07.2006, të ndryshuar.
6. Dokument i lëshuar nga Arkiva e Shtetit në rastet kur dokumentet hipotekore apo kadastrale apo të shpronësimit janë të depozituara tek ky institucion apo çdo dokument tjetër i lëshuar nga institucionet shtetërore që kanë vlerë provuese për hetimin administrativ të çështjes;
  7. Dokument lëshuar nga arkiva hipotekore që ndodhen pranë Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe çdo dokument tjetër ligjor i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes.
- Dokument hartografik për pozicionimin gjeografik të pronës, i cili sipas rastit përbëhet:
1. Dokument hartografik të mëparshëm, që i takon kohës nga fitimi i të drejtës së pronësisë deri në marrjen e padrejtë të pronës nga shteti.
  2. Dokument hartografik aktual i cili përmban të dhëna topografike mbi pronën e pretenduar, i konfirmuar nga institucioni që e lëshon atë .
- Në çdo rast që subjekti depoziton kërkesë të re, sipas një vendimi gjyqësor për rivendosje në afat, pjesë e dokumentacionit shoqërues është edhe vendimi i gjykatës për rivendosjen në afat.
- HAPAT E PROCEDURËS**
1. Subjekti i shpronësuar depoziton, drejtpërdrejt ose me postë, në ATP kërkesën për njohjen/ kthimin apo kompensimin e pronës, shoqëruar me dokumentacionin e lartpërmendur.
  2. Kërkesa e subjektit të shpronësuar duhet të jetë sipas formularit tip, të miratuar nga Ministri i Drejtësisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së, (ky formular gjendet në website-in zyrtar të ATP-së).
  3. ATP-ja pranohet dhe administron kërkesat e subjekteve të shpronësuar kundrejt tarifave të përcaktuara, me urdhër të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të

- Financave.
4. Në rastet kur ATP-ja konstaton mungesë në dokumentacion, subjektit të shpronësuar i kërkohet plotësimi i dosjes përkatëse, brenda 30 ditëve nga gasti i marrjes së njoftimit për plotësim dokumentacioni.
  5. Kërkesat e subjekteve të shpronësuar, të cilat depozitohen nëpërmjet shërbimit postar dhe kanë mangësi në dokumentacionin shoqërues, do t'i kthehen kërkuarit në adresën e dhënë, duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit sipas dispozitave të VKM nr. 255/2010. Kërkesa, siç cilës i mungon adresa e saktë postare, vlerësohet jo e mirëqenë dhe riaktivizohet vetëm me interesimin e kërkuarit pranë zyrave të ATP-së. Në çastin e konstatimit, nga struktura përkatëse e ATP-së, bëhet shpallja publike në mjediset e ATP-së dhe në njësitë e qeverisjes vendore, ku ndodhet prona, objekt pretendimi. Kërkesa e subjektit të interesuar pranohet brenda një afati 3-mujor nga data e konstatimit, në të kundërt kërkesa e subjektit nuk pranohet, me vendim të drejtorit të Përgjithshëm të ATP-së.
  6. Dosja/kërkesa qëndron në sektorin e shqyrtimit deri në plotësimin e plotë të dokumentacionit ligjor dhe teknik të kërkuar, por jo më shumë se 30 ditë nga dita kur subjekti titullar i dosjes ka marrë dënimin për mangësi të saj. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të sipërcituar, propozohet marrjen e një vendimi më gjenden që janë aktet.
  7. Të gjitha kërkesat për njohje dhe kthim të pronës, në zyrat e ATP-së shqyrtohen sipas rendit kronologjik të paraqitjes së tyre në ish- ZRKKP apo ATP Tiranë.
  8. ATP-ja, pas shqyrtimit të kërkesës merr një vendim për dosjen/kërkesën për pranimin/rëzimin e plotë/e pjesëshëm të saj.
  9. Në çdo rast ATP-ja, i dërgon me postë subjektit një kopje të vendimit të saj.
- KOSTO**  
3,000 lekë - kërkesë për shqyrtim

Investimet në infrastrukturë nga veriu në jug, kreu i ARRSH-së zbulon projektet

# Qendro: Ja rrugët e reja që do të ndërtohen

## Investimet kanë nisur në aksin Kukës-Morinë

Qeveria shqiptare ka në fokus të punës së saj investimet në infrastrukturën rrugore sipas standardeve më të mira europiane, me impakt të drejtëpërdrejtë në rritjen e ekonomisë së vendit. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar, (ARRSH) Afrim Qendro, në një intervistë për ATSH-në tha se, gjatë vitit 2018 investimet në infrastrukturën rrugore përfshijnë akset kryesore kombëtare, nga veriu deri në jug të vendit. Investimet kanë nisur në aksin Kukës-Morinë. Projekti i rrugës Kukës-Morinë i nisur para disa vitesh do të përfundojë brenda këtij viti, tha Qendro, ndërsa një projekt i ri, po në këtë aks rrugor, parashikon investime në rehabilitimin e të gjitha defekteve që ka lënë, zbatimin i kontratave në gjithë këto vite, theksoi ai. Ndërkohë mbështetja strategjike për projektet e infrastrukturës përfshinë edhe një sërë aksesh të tjera rrugore. "Ne do të rregullojmë këtë vit, njëjën e Milotit, duke i dhënë zgjidhje të gjitha problemeve që ka komuniteti dhe biznesi rrotull kësaj nyje. Brenda vitit tjetër, parashikojmë të përfundojmë njëjën e Milotit që është një nyje shumë e rëndësishme që lidh korridorin veri-jug, goftë nga pika e doganës së Morisë, por edhe të dy pikave të tjera që vijnë nga Muriqani dhe Hani Hotit", deklaroi kreu i ARRSH-së në një intervistë për ATSH.

### PROJEKTET

Projekti i rrugës nga Ball-drenin deri në Milot, (veriu i Shqipërisë) është në procedurë e sipër, ndërsa kemi në procedurë të përfunduar ndërtimin e rrugës nga Thumana deri në Kashar. Qendro tha se, ne do të investojmë këtë vit në bypass-in e Tepelenës për të cilin është hapur gara dhe parashikohet të fillojnë punimet në fund të vjeshtës si dhe po bëhemi gati të nisim aksin Kardihiq-Delvinë (jug i Shqipërisë). Investime janë parashikuar edhe në vendosjen e sinjalistikës dhe ndërtimin e mbikalimeve. Jo më pak të rëndësishme janë edhe investime që do të ndërmarrim në vendosjen e sinjalistikës dhe ndërtimin e mbikalimeve. "Kemi disa projekte të tjera më të vogla për nga rëndësia dhe impakti ekonomik. Kemi tre lote sin-




Foto ilustruese

jalistike të ndara sipas rajoneve të veriut, qendror dhe jugor dhe vendosjen e mbikalimeve të këmbësorëve nga Thumana deri në

Milot dhe nga Kukësi deri në morinë", theksoi Qendro. Sipas tij, strategjia e investimeve në infrastrukturën kombëtare fillon nga veriu

"Kemi disa projekte të tjera më të vogla për nga rëndësia dhe impakti ekonomik. Kemi tre lote sinjalistike të ndara sipas rajoneve të veriut, qendror dhe jugor dhe vendosjen e mbikalimeve të këmbësorëve nga Thumana deri në Milot dhe nga Kukësi deri në morinë"

e vijon deri në jug të vendit me impakt të drejtëpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe përmirësimin e jetës sociale të komunitetit



Investimet publike rriten me 26%, financimet kryesisht nga donatorë të huaj

Investimet e buxhetit u rritën ndjeshëm në katër muajt e parë të vitit, teksa qeveria ka shpenzuar më shumë para në projekte publike. Të dhënat zyrtare nga Ministria e Financave tregojnë se për periudhën janar-prill investimet publike arritën 18.3 miliardë lekë ose 26 për qind më shumë se sa e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Sipas tabelave zyrtare, thuajse e gjithë rritja ka ardhur nga projektet që financohen me fondet e donatorëve të huaj, ndërkohë që investimet me burime të brendshme kanë shënuar vetëm një rritje të lehtë. Vitet e fundit investimet publike kanë pasur një ecuri të dobët, ku përvëç shkurtimeve të fondeve për shkak të rritjes së borxhit, problematike ka qenë edhe mosrealizimi i projekteve të miratuara. Për gjithë vitin 2018, qeveria ka parashikuar të investojë 86.4 miliardë lekë ose rreth 690 milionë euro në projekte publike. Pjesa më e madhe e këtyre parave shkojë për investime në infrastrukturën rrugore, ku bëjnë pjesë ndërhyrjet në disa akse si "by pass"-et e fierit dhe Vlorës, rruga Tiranë-Elbasan dhe ajo Kukës-Qafë Pllaç. Por përvëç investimeve nga buxheti, qeveria ka nisur edhe programin 1 miliardë euro, i cili parashikon ndërtimin e disa akseve të mëdha kombëtare përmes koncesionit. Deri tani është miratuar kontrata për rrugën e arbrit, ndërkohë që është çelur tenderi për aksin Thumanë-Kashar, të cilat pritet të kushtojnë rreth 500 milionë euro.



### FINANCIMET

Vitet e fundit investimet publike kanë pasur një ecuri të dobët, ku përvëç shkurtimeve të fondeve për shkak të rritjes së borxhit, problematike ka qenë edhe mosrealizimi i projekteve të miratuara.

## Nënstacioni i ri elektrik i Himarës

### Gjikhuri: Investimi i përgjigjet edhe zhvillimeve turistike

Ministri i Infrastruktura dhe Energjisë Damjan Gjikhuri ishte në Bashkinë e Himarës ku inspektoi punimet e fundit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për ndërtimin e nënstacionit të ri elektrik 110/35/20 kV. "Këtu kemi në një nga investimet më serioze që janë bërë vitet e fundit në energjetikë në gjithë zonën e bregut. Ndryshimi këtu është thelbësor, pasi mjafton që qytetarët të kujtojnë disa vite para, furnizimi me energji në këtë zonë ka qenë problematik. Këto probleme nuk ekzistojnë më por ne po i paraprijmë zhvillimeve të pritura turistike për gjithë zonën e bregut", u shpreh ministri Gjikhuri. Administratori i Operatorit të Sistemit të Transmetimit Klodian Gradeci tha se investimi është pjesë e bashkëpunimit shqiptar-gjerman, falë mbështetjes me kredi të butë nga banka kFw. Duke sqaruar se financimi ka nisur që me ndërtimin e Unazës së Jugut 110 kV, Gradeci



sqaroi se "faza e fundit ishin dy nënstacionet, ai i Ori-kumit dhe Himarës me vlerën 6.3 milionë euro. Investimi garanton sigurinë e furnizimit dhe cilësinë e tensionit për të gjithë këtë zonë"-tha Gjikhuri. Ndërkaq, administratori i OSHEE-së Adrian Çela njoftoi se pas këtij investimi nga OST, kompania e shpërndarjes nis në Shtator ndërrhyrjen për rrjetin e ri 20 kV që prek gjithë vijën bregdetare. "Kemi arritur të garantojmë një sezon turistik normal për të gjithë pushuesit. Ky është viti i tretë që kemi aplikuar dhe njësitë e gatish-

mërisë. Pra, skuadra speciale nga qytete të tjera të Shqipërisë alokohen gjatë 3 muajve të sezonit nga Velipoja, përgjatë gjithë vijës bregdetare, Durrës, Shëngjin, Golem, Vlorë deri në Sarandë. Dua të theksoj se ky investim i paraprin një investimi tjetër të madh që do të nisë Operatori i Shpërndarjes për të cilin puna do të nisë në muajin shtator. Është një investim në shifrën rreth 16 milion eurove vetëm për zonën e bregdetit ku është Himara, Dhërmiu, Qeparoi, Vuno, Livadhja, Jala e Palasa do bëhen 7 fidera të rinj", nënvizoi Çela.

## TREGUESIT

### Të ardhurat nga renta minerare rriten me 8.2%

Të ardhurat nga renta minerare në eksport janë realizuar në vlerën 1.78 miliardë lekë ose 8.2% më shumë krahasuar me 4-mujorin e parë të vitit 2017. Sipas raportit mbi treguesit fiskalë të publikuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë rritur me 161 milionë lekë, si rezultat i rritjes së sasisë së eksportuar me rreth 52 mijë tonë. Efekti i rritjes së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare llogaritet 74 milionë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke sjellë rritje të rentës për njësi nga 3.1 lekë/kg në 3.4 lekë/kg. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie për shkak të rënies së sasisë së eksportuar dhe për shkak të rënies së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.



**STRATI** Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shërbim në ankand të pasurive të paluajtshme:

- "Ndërtës", me sipërfaqe 44 m<sup>2</sup>, ndodhur në Selenicë, Kolonjë, me Nr. 570/49-ND Pasurie, vol. 7, faqe 249, Zona Kadastrale 3284, regjistruar në pronësi të Shkëlzen Sulejmani. Çmimi fillestar i ankandit është 201.600 Lekë.
- Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.06.2018. Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pali. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7 Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

## U rrëzua në Shpellën e Pëllumbasit, gjendet pas dy javësh trupi i pajetë i Xhorxho Seferit

Pas më shumë se dy javë kërkimesh është nxjerrë nga palombarët trupi i pajetë i Xhorxho Seferit, i cili u rrëzua në Shpellën e Pëllumbasit. Më datë 19.05.2018 në "Shpellën e Pëllumbasit" shtetasi Xhorxho Seferi, rreth 20 vjeç, si pasojë e rënies aksidentale nga gryka e kanionit në ujërat e lumit Erzen humbi jetën, dhe trupi i tij nuk u gjend si pasojë e marrjes nga rrjedha e ujit. Policia bëri me dije se ditën e diel rreth orës

15.00, rreth 1 kilometër larg nga vendi ku shtetasi Xh. S., ra nga lartësia, nga palombarët e Reneas është gjetur dhe është nxjerrë nga ujërat e lumit Erzen trupi i shtetasit Xh. S., rreth 20 vjeç. "Pavarësisht kërkimeve intensive për një javë rresht nga palombarët e Reneas dhe një grup punonjësish të Stacionit të Policisë Farkës në terren shumë të vështirë nuk u bë e mundur gjetja e

trupit të 20-vjeçarit. Kërkimet nuk u ndërpre, por çdo ditë dy Polombarët të Reneas dhe disa punonjës Policie të Farkës kanë krehur shtratin e Lumit. Rreth 1 km më poshtë vendit ku dyshohej se ishte mbytur, palombarët e Reneas vendosën një rrjetë pritëse me qëllim pengimin e trupit për të mos e marrë rrjedha e lumit. Gjatë ditëve të kërkimit u devijua pothuaj 1/3 e

rrjedhës së lumit. Sot rreth orës 15:00, në vendin ku palombarët kishin vendosur rrjetë pritëse, dy palombarët të Reneas kanë gjetur trupin e viktimës. Trupi i viktimës është nxjerrë dhe transportuar tek autoambulanca nga palombarët, punonjësit e policisë të Farkës dhe nga zjarfikësit ku po transportohet për në morgun e spitalit", thuhet në njoftimin e policisë.



Vijojnë hetimet, dyshohet për persona të tjerë të përfshirë në trafikim

Ina Allkajari

Disa orë pas deklaratës së Gjovalin Lokës, drejtorit për rendin dhe sigurinë publike, Policia e Shtetit përmes një njoftimi për mediat jep detaje rreth operacionit anti-kanabis në Krujë. Mësohet se falë këtij operacioni u bë e mundur asgjësimi i 2080 bimë Cannabis Sativa. Në pranga kanë rënë persona të cilët dyshohet se ishin pronarët e këtyre parcelave me kanabis. Konkretisht uniformat blu arrestuan Ferdjan Zalla 33 vjeç, Mondi Zalla 42 vjeç dhe Arben Babasi 42 vjeç. Bëhet me dije se policia po heton edhe për persona të tjerë që dyshohet se mund të kenë bashkëpunuar me 3 të arrestuarit. Ndërkohë në një tjetër operacion, zhvilluar në zonat pyjore të Nikles, policia zbuloi dhe asgjësoi 675 rrënjë kanabis sativa.

### OPERACIONI

Pas një hetimi proaktiv disa muaj, në vijim të operacionit "Krasta 2" specialistët për Krimet në Komisarjatin e Policisë Krujë asgjësuan 2080 bimë Cannabis Sativa, operacioni i përbashkët midis Komisarjati të Policisë Krujë, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, Forcave Operacionale dhe FLO të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në vijim të këtij operacioni u ekzekutuan 3 urdhra ndalimi dhe u procedua në gjendje të lirë 1 shtetas. Në pranga ranë shtetasit Ferdjan Zalla 33 vjeç, banues në Krujë; Mondi Zalla 42 vjeç, banues në Fushë - Krujë dhe Arben Babasi 42 vjeç, banues në Fushë - Krujë. Gjithashtu, filloi procedimi penal në gjendje të lirë për shtetasin G.Sh. 42 vjeç, banues në Krujë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit". Shtetasit e mësipërm, dyshohet se në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me persona të tjerë (për të cilët vazhdon hetimi), në vendin e quajtur Krastë kanë kultivuar në disa ambiente të hapura në

# Parcela me kanabis në Krujë, ja emrat e të arrestuarve

## Policia asgjëson 2700 bimë narkotike



brendësi të pyllit 2080 bimë narkotike Cannabis Sativa, të cilat u asgjësuan me anë të djegies. Mësohet se operacioni është drejtuar në terren nga vetë drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu. Sakaq materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për vepr

time të mëtejshme për veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" në bashkëpunim në ngarkim të shtetasve F.Zalla, M.Zalla dhe A.Babasi si dhe "Moskallëzimi i krimit" në ngarkim të shtetasit G.Sh.. Ndërkohë Specialistët për Krimet në Komisarjatin e Krujë, në bashkëpunim me

efektivët e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, FLO të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në bazë të informacioneve të siguruar nga strukturat policore dhe në zbatim të Plan Veprimit për kontrollin e territorit për kultivim të bimëve narkotike, në Njësinë Ad-

### ARRESTIMET

Në vijim të këtij operacioni u ekzekutuan 3 urdhra ndalimi dhe u procedua në gjendje të lirë 1 shtetas. Në pranga ranë shtetasit Ferdjan Zalla 33 vjeç, banues në Krujë; Mondi Zalla 42 vjeç, banues në Fushë - Krujë dhe Arben Babasi 42 vjeç, banues në Fushë - Krujë.

ministrative Nikel, në ambient të pyllëzuar gjetën dhe asgjësuan 675 bimë Cannabis Sativa. Po punohet për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë për veprime të mëtejshme për veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike".

### SHKURT

**Plagos komshiu me mjete prerëse, pranga 58-vjeçarit në Peqin**

ELBASAN-Policia e Elbasanit ka parandaluar ditën e djeshme përshkallëzimin e mëtejshëm të një konflikti mes fqinjëve në qytetin e Peqinit. Në Sallën Operative të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, ka ardhur një telefonatë se në fshatin Karthnek, Peqin, ka një konflikt mes dy fqinjëve, deri në përdorimin e mjeteve prerëse. Menjëherë shërbimet e policisë kanë shkuar në vendin e ngjarjes, ku kanë parandaluar përshkallëzimin e konfliktit, si dhe bënë arrestimin në flagrancë të shtetasit Osman Tabaku, 58 vjeç, banues në fshatin Karthnek, Peqin, i cili kishte goditur me mjete prerëse fqinjin e tij shtetasin M.T, 62 vjeç, banues në fshatin Karthnek, Peqin, duke i shkakuar plagë në qafë. I dëmtuari është transportuar në spitalin rajonal Elbasan, dhe është jashtë rrezikut për jetën. Konflikti dyshohet se ka ndodhur për motive të dobëta. Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprën penale, "Plagosje e rëndë me dashje".

## Arrestohet shoferi shqiptar në Greqi, u kap me një sasi të madhe droge



Një sasi e madhe droge raportohet se është kapur ditën e djeshme në afërsi të Janinës. Një shqiptar që udhëtonte me një automjet u arrestua, ndërsa në makinë atij u bllokuan disa çanta me lëndë narkotike. Burime zyrtare të Policisë së Sh-

tetit në Shqipëri thanë se pas komunikimeve që kanë pasur me policinë greke është mësuar se droga është kapur pranë kufirit me Maqedoninë. Për këtë shkak dyshimet e policisë greke janë se lënda narkotike ka hyrë nga Greqia. Por mediat greke

shkruajnë se shqiptari u kap disa kilometra larg kufirit shqiptar në zonën e Pogonit, pranë Sitarias. Ende nuk dihet emri i shqiptarit të arrestuar, por ndaj tij pritet të ngrihet akuzat e trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Policia greke tashmë

është duke kryer procedurat e peshimit të lëndës narkotike. Shqiptari i ndaluar tashmë ndodhet i izoluar në një nga stacionet policore greke duke pyetur mbi rrugëtimin e mundshëm të drogës që në momentin e kapjes së saj. Ndërkohë vijojnë hetimet për të zbuluar nëse ka persona të tjerë të përfshirë në këtë linjë të trafikimit të drogës.

Zbulohen deklaramet e bëra për periudhën 2004-2016, ja çfarë verifikoi ILDKPKI

Ina Alkanjari

Një tjetër prokurorë do të kalojë në 'sitën' e vetingut. Para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të dalë Anila Leka, prokurorë e Prokurorisë së Përgjithshme dhe kandidatë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Seanca e KPK-së do të mbahet ditën e sote, ndërkohë, trupa gjyqësore përbëhet nga Firdes Shuli, Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Anila Leka do të dalë para Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, organit të bazë të vetingut, për t'u njohur me rezultatet e hetimit të thelluar për ligjshmërinë e pasurisë, kontaktet e mundshme me botën e krimtë dhe aftësitë profesionale. Pra, analiza e pasurisë është një ndër tri shtyllat e rivlerësimit, së bashku me kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Birn paraqet ndryshimin e pasurisë së deklaruar të prokurorës Anila Leka nga viti 2004 deri në fund të vitit 2016. Ky raport është prodhuar pas administrimit të deklaratave të pasurisë së këtij subjekti nga Inspektoriatin i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, ILDKPKI. Ai ka për qëllim bërjen e transparencës mbi pasurinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve që i nënshtrohen procesit të vetingut. Të dhënat e analizuar nga BIRN tregojnë që prokurorja e organit qendror të akuzës, Anila Leka zotëronte një pasuri familjare në vlerën e rreth 4 milionë lekëve në vitin 2004. Në fund të vitit 2016, pasuria e saj rezultoi të jetë 10.4 milionë lekë ose 2.6 herë më e lartë se viti fillestar. Të ardhurat kryesore të zonjës Leka përbëhen më shumë se 96 për qind nga paga prej funksionit. Të ardhurat nga interesat bankare përfaqësojnë 3.6 për qind të të ardhurave, të cilat kapin vlerën totale 21.5 milionë lekë në 13 vitet e analizuar. Asetet e zonjës Leka në fund

# Vetingu, në 'sitë' prokurorja Anila Leka, zbardhet skeda e pasurisë

## Ka në pronësi dy apartamente 6.2 milionë lekë



### PASURIA

Sa u takon pasurive të paluajtshme, prokurorja Anila Leka ka në pronësi vetëm dy apartamente. Ajo deklaron blerjen e një apartamenti banimi 2+1, në vitin 2004, me sipërfaqe 85 m<sup>2</sup>, me vlerë 35 mijë dollarë. Si burim deklaron shitjen e një banese si dhe kursime. Prokurorja deklaron, gjithashtu, edhe blerjen e një apartamenti në vitin 2014, me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> dhe me vlerë 3 000 000 lekë.

logjik 13 deklaratave pasurie dhe asnjëra prej tyre nuk rezultoi me probleme. Duke qenë se ky raport bazohet në të dhëna statistikore të analizuar nëpërmjet një databaze, ai nuk nxjerr përfundime mbi pasurinë e subjektit nëse ajo mbulohet me burime të ligjshme ose jo, por mëton të informojë publikun mbi pasurinë e deklaruar të zyrtarit publik nëpërmjet një formati të thjeshtë dhe të kuptueshëm grafik. Prokurorja Anila Leka e ka filluar karrierën e saj në vitin 2004 dhe prej asaj kohe është subjekt i deklaramet të pasurisë në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, ILDKPKI. Prej vitesh në Prokurorinë e Përgjithshme, Leka ka punuar gjithashtu si eksperte në Shkollën e Magistraturës.

6.2

### MILIONË LEKË

Asetet e zonjës Leka në fund të vitit 2016 ndahen në 6.2 milionë lekë në pasuri të paluajtshme, rreth 576 mijë lekë në kursime cash dhe 3.6 milionë lekë në likuiditetet bankare.


të vitit 2016 ndahen në 6.2 milionë lekë në pasuri të paluajtshme, rreth 576 mijë lekë në kursime cash dhe 3.6 milionë lekë në likuiditetet bankare. Konkretisht sa i takon pasuritë të paluajtshme, prokurorja Leka ka në pronësi vetëm dy apartamente. Ajo deklaron blerjen e një apartamenti banimi 2+1, në vitin 2004, me sipërfaqe 85 m<sup>2</sup>, me vlerë 35 mijë dollarë. Si burim deklaron shitjen e një banese si dhe kursime.

Prokurorja deklaron, gjithashtu, edhe blerjen e një apartamenti në vitin 2014, me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> dhe me vlerë 3 000 000 lekë. Përveç analizës për rritjen/uljen e pasurisë, strukturën e aseteve dhe të ardhurave, ky raport paraqet dhe kontrollin aritmetik/logjik të deklarametve të subjektit si dhe "flamujt e kuq" që identifikohen gjatë kontrollit. Në rastin e zonjës Leka iu nënshtroan kontrollit aritmetik/

## Zbardhen të ardhurat e Dritan Prençit

# Prokurori i çështjes "Tahiri", më datë 5 qershor përpara KPK

Përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të dalë më datë 5 qershor në orën 11:30, prokurori i Krimeve të Rënda Dritan Prençi. Ndaj tij do të zhvillohet seanca dëgjimore, ku do të njihet nga trupa gjyqësore me përfundimet e kontrollit të pasurisë, integritetit dhe profesionalizmit të tij. Kujtojmë se Prençi është një ndër prokurorët që po heton ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Dritan Prençi ka në dorë edhe dosje si ajo e Orest Sotës si dhe financierit të Habilajve, Nazer Seiti për ekstradimin e të cilit është në hetim disiplinor nga prokuroria e Durësit, së bashku me kolegun e tij Vladimir Mara. Sipas të dhënave të deklaruara deri në vitin 2015 të publikuara në Open Spending Data, Prençi ka deklaruar në vitin 2008 pronësinë e një apartamenti me sipërfaqe 78 m<sup>2</sup> dhe vlerë thuajse 32 mijë euro, të blerë me kredi bankare për shlyerje në



10 vjet. Por në 2011-n, prokurori ka deklaruar një tjetër kredi bankare me afat shlyerje 8 vjet, nëpërmjet së cilës ka shlyer në total edhe kredinë e marrë për blerjen e apartamentit. Në pronësi të tij ka edhe një makinë tip Volkswagen me vlerë 2000 euro. Burim të të ardhurave, prokurori deklaron pagën e tij dhe të bashkëshortes, të cilat do të kalojnë në sitën e trupës gjyqësore të

vetingut të përbërë nga Genta Tafa (Bungo), Pamela Qirko, Suela Zhegu. Ai deklaroi 1 383 540 lekë pagën dhe shpërblime si dhe 408 000 lekë të ardhura të bashkëshortes nga paga si infermiere pranë QSUT. Përveç Ditane Prençit po në 5 qershor në orën 10 të mëngjesit përball Komisionit të Pavarur të Kualifikimit do të jetë edhe gjyqtari i Gjykatës së Lartë, Edmond Islamaj.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje e Blu Diesel dhe benzine pa plumb 95 oktan, për nevojat e Bankës së Shqipërisë në Tiranë dhe në dege për një periudhë një vjeçare"**

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 20.000.000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqjen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje e Blu Diesel dhe benzine pa plumb 95 oktan, për nevojat e Bankës së Shqipërisë në Tiranë dhe në dege për një periudhë një vjeçare"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 27 Qershor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



# EMIGRANTËT NË ITALI PËRFITIMET

Voltiza Duro

Ekspertja: Të favorizuar, familjet me shumë pjesëtarë dhe të ardhura të pakta

## Ndihma familjare nga Italia për emigrantët shqiptarë

*Aliaj: Kriteret dhe kategoritë që përfitojnë*

Emigrantët shqiptarë që jetojnë në Itali mund të përfitojnë ndihmë familjare, nëse përmbushin kriteret e përcaktuara bazuar në të ardhurat që kanë. Kjo pagesë nga shteti italian u jepet punonjësve të punësuar; atyre me përfitime nga papunësia; punonjësve të punësuar në bujqësi; punonjësve që shërbejnë në familje; punonjësve të reregjistruar në administrime të ndara; mbajtësve të pensioneve; mbajtësve të përfitimeve nga sigurimet shoqërore dhe punonjësve në kushte të tjera me pagesa direkte.

### KUSHTET E PËRFITIMIT

Synimi kryesor i dhënies së kësaj pagese është për të ndihmuar familjet e të punësuarve publikë e privatë dhe pensionistët që janë mbajtës të pensionit si rezultat i punës si të punësuar, kur përbërja familjare është me shumë persona dhe të ardhurat janë nën kufirin e të ardhurave të përcaktuara nga ligji. "Llogaritjet bëhen sipas përbërjes familjare, të numrit të anëtarëve të familjes dhe të ardhurave të përgjithshme të këtij numri, ku përfshihen shuma pagesash sipas kufijve të të ardhurave, duke u favorizuar ato familje që janë në gjendje më të vështirë (p.sh. prindër të vetëm apo anëtarët me aftësi të kufizuara). Shumat e pagesave publikohet çdo vit nga INPS në tabela të vlefshme nga 1 korriku i çdo viti deri më 30 qershor të vitit të ardhshëm. Të ardhurat familjare për t'u marrë në konsideratë përdhënie e pagesës, janë të ardhurat e pagës bruto që merren në përllogaritjet tatumore para zbritjeve që bëhen nga këta organe", thekson për "Gazeta Shqiptare", drejtuesja e patronatit, INAS Albania, Beskida Aliaj. Kjo e fundit shton se merren në konsideratë edhe të ardhurat të përgjashuara nga taksat dhe ata që janë si objekt i tatimit në burim, në qoftë se kjo shumë kalon një total prej 1,032.91 €, e cila llogaritet si produkt i vitit kalendarik më 1 korrik të çdo viti, deri më 30 qershor të vitit të ardhshëm. Pagesën për ndihmë familjare mund ta përfitojnë familjet që përbëhen nga: punëkërkuar ose mbajtës të pensioneve; bashkëshorti, i cili nuk është ligjërishit dhe efektivisht i ndarë edhe pse nuk bashkëjeton, por nuk e ka braktisur familjen; fëmijët dhe të barasvlershëm me ta, nën moshën 18 vjeç, që bashkëjetojnë ose nuk bashkëjetojnë; si dhe fëmijët dhe



### KUSHTI

"Pagesa për ndihmë familjare nuk jepet në rast se shuma e të ardhurave nga puna si i punësuar ose e marrë nga pensioni, ose përfitim tjetër të sigurimeve shoqërore të prejardhura nga puna si i punësuar, është më e vogël se 70 % e të ardhurave familjare në total", -bën me dije Aliaj.

### TE DHENA

Personat që nuk përfshihen në përbërjen familjare:

- Bashkëshortët ligjërishit dhe efektivisht të ndarë;
- Bashkëshortët që kanë braktisur familjen
- Fëmijët në kujdestari nga bashkëshort tjetër ( në rast të ndarjes ligjore ose divorcit )
- Familjarë të qytetarëve të huaj, jo rezident në Itali
- Fëmijët natyralë, të njohur nga të dy prindërit që nuk bashkëjetojnë me aplikuesin.
- Fëmijët natyralë të aplikuesit të martuar, që nuk janë përfshirë në përbërjen e familjes ligjore.
- Fëmijët dhe të barasvlershmit madhorë, jo të paaftë fizikisht dhe që janë të aftë për punë.
- Fëmijët e mitur dhe madhorë të paaftë fizikisht, të cilët janë martuar.
- Vëllezërit, motrat dhe nipërit e aplikuesit edhe në rast se janë të paaftë, që janë jetimë vetëm të një prindi ose mbajtësit të një pensioni familja, ose që janë martuar.
- Prindërit dhe të tjerë persona të shtuar.

të barasvlershëm me ta, maxhorenë të paaftë, me kusht që të jenë të pamartuar, të cilët duhet të jenë të pajisur me autorizimin përkatës. Sipas legjislacionit italian konsiderohen persona të paaftë ata persona, që për arsye fizike ose mendore, janë në pamundësi absolute dhe të përhershme për t'u inçuanur në punë produktive. Gjithashtu këtë ndihmë familjare mund ta marrin edhe familjet që kanë në përbërje: stu-

dentët ose specialistët, të moshës mbi 18 vjeç dhe nën moshën 21 vjeç, me kusht që të jenë pjesë e "përbërjes së numrit në familje", kjo vetëm për familjet me të paktën katër fëmijë, të gjithë nën moshën 26 vjeç ; vëllezërit, motrat dhe nipërit e aplikantit minoronë dhe maxhorenë, ose të paaftë, vetëm në rast se ata kanë humbur të dy prindërit, nuk e kanë fituar të drejtën e përfitimit të pensionit familjar dhe nuk janë

të martuar; si dhe nipërit të moshës nën 18 vjeç, që jetojnë në ngarkim të aplikuesit. "Mbajtësit e pensionit të pleqërisë dhe familjar, kanë të drejtë pagese për ndihmë familjare, nëse familja përbëhet nga bashkëshortë të pasjetuar (superstite) që janë mbajtës pensioni, dhe nga fëmijët ose ekuivalentë të tyre nën moshën 18 vjeç ose maxhorenëve të paaftë mbajtës ose bashkëmbajtës të pensionit. Pagesa për ndihmë

### PËRFITUESIT

Pagesën për ndihmë familjare mund ta përfitojnë familjet që përbëhen nga:

- punëkërkuar ose mbajtës të pensioneve;
- bashkëshorti i cili nuk është ligjërishit dhe efektivisht i ndarë edhe pse nuk bashkëjeton, por nuk e ka braktisur familjen
- fëmijët dhe të barasvlershëm me ta, nën moshën 18 vjeç, që bashkëjetojnë ose nuk bashkëjetojnë;
- fëmijët dhe të barasvlershëm me ta, maxhorenë të paaftë, me kusht që të jenë të pamartuar, të cilët duhet të jenë të pajisur me autorizimin përkatës. Konsiderohen persona të paaftë ata persona, që për defekt fizik ose mendor, janë në pamundësi absolute dhe të përhershme për t'u inçuanur në punë produktive.
- fëmijët dhe të barasvlershëm me ta, studentët ose specialistët, të moshës mbi 18 vjeç dhe nën moshën 21 vjeç, me kusht që të jenë pjesë e "përbërjes së numrit në familje", kjo vetëm për familjet me të paktën katër fëmijë, të gjithë nën moshën 26 vjeç ;
- vëllezërit, motrat dhe nipërit e aplikantit minoronë dhe maxhorenë, ose të paaftë, vetëm në rast se ata kanë humbur të dy prindërit, nuk e kanë fituar të drejtën e përfitimit të pensionit familjar dhe nuk janë të martuar.
- nipërit të moshës nën 18 vjeç, që jetojnë në ngarkim të aplikuesit.

familjare nuk jepet në rast se shuma e të ardhurave nga puna si i punësuar ose e marrë nga pensioni, ose përfitim tjetër të sigurimeve shoqërore të prejardhura nga puna si i punësuar, është më e vogël se 70 % e të ardhurave familjare në total", -bën me dije Aliaj.

### KËRKESA

Kërkesa duhet të paraqitet për çdo vit kur personit i ka lindur e drejta për ta përfituar nga punëdhënësi përkatës; INPS në rast se aplikanti është i punësuar në shërbimin familjar etj. Nëse kërkesa paraqitet për pagesa të periudhave të mëparshme, fillimi i pagesave të prapambetura paguhet deri në një maksimum prej pesë vjetësh. Ekspertja e pensioneve bën me dije për "GSH" se nuk duhet të deklarohen si të ardhura: trajtimet me pagesa në përfundim të raporteve të punës; trajtimet e familjes, të përfituara e të pagueshme sipas ligjit; si pagesat vjetore të paguara

nga INAIL, pensionet e luftës, pensionet për viktimat e një aksidenti; pagesa për personat që shoqërojnë invaliditet civil, të verbër absolutë civil, të mitur invalidë të cilët nuk mund të ecin, si dhe për pensionistët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, nuk mund të deklarohen si të ardhura pagesat e mundësimit të komunikimit për persona të shurdhër dhe për persona të verbër të pjesshëm; të ardhura për dëme të pakthyeshme në vaksinimet e detyrueshme, transfuzioneve të gjakut dhe injeksione të ndryshme; të prapambetura të pushimeve nga puna, të ardhura të ofruara, të cilat i referohen viteve të mëparshme; të ardhura nga transferta për pjesën që nuk u nënshtrohen tatimeve fiskale; si dhe të ardhurat për ushqim, marrë nga bashkëshorti/ja ndarë ligjërishit në ngarkim të aplikuesit/ ses të kërkuara me destinacion për ushqimin e fëmijëve.

Tapi për tokën, përfituesit në Elbasan, Durrës, Korçë, Vlorë, Tiranë e Dibër

Ornela Manjani

Qeveria u njeh të drejtën mbi truallin ku kanë ndërtuar pa leje më shumë se 1078 pronarëve në të gjithë vendin. Pak ditë më parë Këshilli i Ministrave vendosi miratimin e kalimit të së drejtës së pronësisë në favor të subjekteve përfituese për 1078 parcela ndërtimore të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin. Sipas vendimit, mësohet se numri i parcelave ndërtimore,

# Ndërtimet pa leje, qeveria u njeh të drejtën mbi truallin 1078 pronarëve

## Në kryeqytet, numri i parcelave ndërtimore është 298

për të cilat miratohet kalimi i pronësisë sipas qarqeve është si më poshtë vijon: Për qarkun Elbasan (ZVRPP Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin), numri i parcelave ndërtimore është 416;

për qarkun Berat (ZVRPP Berat, Skrapar dhe Kuçovë), numri i parcelave ndërtimore është 29; për qarkun Durrës (ZVRPP Durrës), numri i parcelave ndërtimore është 16; për qarkun

Tiranë (ZVRPP Tiranë dhe Kavajë), numri i parcelave ndërtimore është 298; për qarkun Korçë (ZVRPP Korçë dhe Pogradec), numri i parcelave ndërtimore është 20; për qarkun Fier (ZVRPP

Lushnjë dhe Fier), numri i parcelave ndërtimore është 101; për qarkun Vlorë (ZVRPP Vlorë dhe Sarandë), numri i parcelave ndërtimore është 39; për qarkun Shkodër, numri i parcelave

ndërtimore është 28; për qarkun Gjirokastrë (ZVRPP Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet), numri i parcelave ndërtimore është 85 dhe për qarkun Dibër, numri i parcelave ndërtimore është 46.

### LISTA EMERORE E PËRFITUESVE TË KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË DHE MASA E VLERA E SHPERBLIMIT PËR SUBJEKTET QË KOMPENSOHEN

QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE 8527			
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1327			
368	KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHOPIRISË		15
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1742			
369	MIMOZA	LLAZAR	HALILI
370	FATMIR	IRAKLI	KERÇYKU
371	SHPETIM	PETER	ISMALI
372	AVRAM	STEFAN	BINJAKU
373	MERKUR	DHIMITER	BEZHANI
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1919			
374	BUKURI	LEFI	BËRDUFI
	ALDI	ALEKSI	BËRDUFI
	DORINA	ALEKSI	BËRDUFI
			52.2
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3298			
375	KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHOPIRISË		174.3
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3589			
376	XHEZO	OSMAN	XHELILI
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3705			
377	KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHOPIRISË		44.4
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3827			
378	NAZMI	SUTKI	ÇUPI
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3895			
379	KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHOPIRISË		387
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8521			
380	ISMAIL	FADIL	SKENDERI
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8522			
381	ISMAIL	FADIL	SKENDERI
	ANASTASI	LEFI	SKENDERI
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8525			
382	PETRIT	ISLAM	ZEQIRI
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 8526			
383	FATMIR	ALI	ABEDIN
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2328			
384	AVDUL	XHEZO	LATIFI
385	EDLIRA	DHIMITER	BOJA
386	FLAJDI	FLAMUR	BOJA
	ARBEN	GANI	KUQJA
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3376			
387	JONI	SHYOYRI	MADHI
388	MUSA	RIZA	TAFI
389	VATHI	DEMIR	IDRIZI
390	NDRIÇIM	RIZA	TAFI
391	RIAD	KASEM	XHARDJA
392	NDRIÇIM	ASLLAN	KUQJA
393	TAULANT	ASLLAN	KUQJA
394	SHEFQET	HARUN	LAZI
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1085			
395	NEHNET	SHERIF	HASA
	SHERIF	HASAN	HASA
396	ADILE	KADRI	BAXHAKU
	BUJAR	MERSIN	SINA
397	SHPETIM	XHAFERR	XHAKOJ
398	HASAN	MUJARREM	ALBRAHIM
399	FLORENC	REFIK	XHAKOJ
400	QEMAL	MUSTAFA	BAXHAKU
401	EDUART	IBRAHIM	HAKA
402	BAJRAM	SULI	NERGJONI
403	ISMET	VEDIN	META
404	ARTUR	RRAPUSH	SINA
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1258			
405	BASHKIM	RRAPUSH	SINA
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 1285			
406	MYFTINIA ELBASAN		242
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 2511			
407	NURUJE	QAMIL	FARKA
QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE 3764			
408	ILIR	RIZA	VERCANI
409	BEQIR	ISMAL	HAKA
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 2924			
410	FEJZULLA	GANI	MEKSHI
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3203			
411	BARDHYL	ISAK	DASHI
412	XHEMIL	SHABAN	ÇUKU
413	GEZIM	BAJRAM	HOXHA
414	OSMAN	SELIM	BOGDANI
QARKU Elbasan, ZVRPP Librazhd, ZONA KADASTRALE 3552			

DREJTORIA E ALIUZNI-BERAT			
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8501			
415	ARBEN	FLORI	RIRA
	DRITAN	FLORI	RIRA
	ANDI	FLORI	RIRA
			414.3
DREJTORIA E ALIUZNI-BERAT			
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8501			
416	VALBONA	MYQEREM	BUZO
	AZBIE	IZET	BUZO
	AMELIO	IZET	BUZO
417	ARMAND	QEREM	BAZAJ
418	ARMAND	QEREM	BAZAJ
419	VALTER	MAKSIM	HASANAJ
420	FATMIR	HAXHI	KASEMI
	HASUE	AVDYL	KASEMI
			289
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 1587			
421	GAZMENT	BAFTJAR	ZYKA
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8502			
422	MARKO	PECI	TASE
	ATHINA	MINO	TASE
			500
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 2848			
423	BEHAR	PETREF	BEGOLLARI
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8501			
424	SULO	XHEVIT	QOSE
			300
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 1559			
425	AGRON	QEMAL	XHERIMEJA
			134.6
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 3682			
426	NIKOLLAQ	STAVER	PALI
			24.4
QARKU Berat, ZVRPP Skrapar, ZONA KADASTRALE 3666			
427	SHKELQIM	SHYOYRI	SHENJOLLI
			500
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 3682			
428	ALEKS	KOLI	POCI
			200
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8501			
429	CLABONA	SHKELQIM	HASANAJ
			110
QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA KADASTRALE 2179			
430	THANAS	JORGJI	GODE
			310
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8501			
431	RAMI	ESAT	MITVA
432	LLAMBI	JANAQ	MITVA
433	TRIFON	LONI	QYTKU
			11
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 1587			
434	HYQMET	FEJZO	HYSI
			85
QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA KADASTRALE 2310			
435	BLEDAR	FEJZO	RIKA
436	ENVER	REXHEP	BAHO
437	ALEKSANDER	ENVER	BAHO
			500
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 2381			
438	ALI	DERVISH	BILCARI
			83.9
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 1217			
439	ARBEN	NAZMI	DERVISHI
			410
QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8503			
440	EMILJANO	DHIMITRAQ	LLAZI
	DHIMITRAQ	KOLI	LLAZI
			132
QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA KADASTRALE 2310			
441	BUJAR	BAJRAM	KURTI
442	AVDULLA	IDAET	BEGA
443	ENEIDA	ENVER	AHMETAJ
444	BASHKIM	RAMADAN	MARA
			268
DREJTORIA E ALIUZNI-KAVAJE			
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1131, ZVRPP KAVAJE			
445	XHEVAIR	HAMIT	HOXHA
			223
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3817, ZVRPP KAVAJE			
446	Bisha	OSMAN	HOXHA
			396
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2539, ZVRPP KAVAJE			
447	BEQIR	BAJRAM	TAFI
			78.6
448	EDMOND	AZIZ	CURUMI
	ROLAND	EGEREM	BUSHI
	ALKETA	HYSNI	BUSHI
			58.8
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3235, ZVRPP KAVAJE			
450	XHEMAL	BAJRAM	KACANI
			409.8
QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8552, ZVRPP KAVAJE			
451	AVRAM	BAJRAM	LISI
	AVNI	BAJRAM	LISI
			388.3
452	RENATO	NAZMI	LISI
			388.4
453	HYSNI	ARBEN	KANANI
			281

454	SEFEDIN	ISMAIL	KANANI	470
455	QAZIM	FAIK	DRIZA	
456	BASHKIM	RAMADAN	ZIU	
457	RIFAT	HAJRULLA	XHIHANI	500
458	RIFAT	HAJRULLA	XHIHANI	500
459	SKENDER	HAJRULLA	XHIHANI	477.6
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1072, ZVRPP KAVAJE</b>				
462	SELIM	ETEM	SHEHU	218.1
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1131, ZVRPP KAVAJE</b>				
463	BETIM	KADRI	GJOKU	236.5
464	KADRI	SALIH	GJOKU	312
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1397, ZVRPP KAVAJE</b>				
465	SHPETIM	FADIL	CIKALLESHI	394.5
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1791, ZVRPP KAVAJE</b>				
466	ALI	ISUF	ÇOPA	300
467	RUZHDI	ALI	ÇOPA	
467	ASTRIT	SHYQYRI	BODLLI	500
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1814, ZVRPP KAVAJE</b>				
468	RUZHDI	HASAN	SKUQI	393
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 1815, ZVRPP KAVAJE</b>				
469	BILAL	VEIZ	SHABA	500
470	SOKOL	BANUSH	DELIU	444.9
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2071, ZVRPP KAVAJE</b>				
471	PETRIT	SALI	XHAFA	402
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2140, ZVRPP KAVAJE</b>				
472	SUL	ZEKE	VOKRRI	263.4
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2538, ZVRPP KAVAJE</b>				
473	AGIM	HAJDAR	LECINI	500
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2539, ZVRPP KAVAJE</b>				
474	ABAZ	QANI	KAMBERI	461.5
475	SEFEDIN	HALIT	XEKA	412.8
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2721, ZVRPP KAVAJE</b>				
476	BESNIK	ZEJNEL	GJANA	500
476	DRITAN	ZEJNEL	GJANA	
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 2888, ZVRPP KAVAJE</b>				
477	KIMET	FERHAT	SUBASHI	263
478	GENTJAN	FERHAT	SUBASHI	263
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3204, ZVRPP KAVAJE</b>				
479	EQEREM	XHEMAL	ÇAÇA	500
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3234, ZVRPP KAVAJE</b>				
480	AHMET	BAFTJAR	TOPALLI	344.4
481	AGIM	LIMON	PICI	59.2
482	SHPETIM	ADEM	GOSA	349.8
483	ASTRIT	BISHA	CEKA	497
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3271, ZVRPP KAVAJE</b>				
484	YLLI	MYRTEZA	ÇOPA	400
485	NEZIR	IMER	ÇOPA	476.7
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3337, ZVRPP KAVAJE</b>				
486	VIKTOR	SADI	HAKA	242.4
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3961, ZVRPP KAVAJE</b>				
487	RUZHDI	QAZIM	ÇOPA	398.1
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8551, ZVRPP KAVAJE</b>				
488	MUSTAFA	ISMAIL	KETOSHI	500
489	LAME	TALUSH	HOXHA	347
490	SKENDER	EMIN	HYKA	498.9
491	XHAFERR	OSMAN	QEROSI	279.7
491	BUJARE	RASIM	QEROSI	
492	ILIR	RESHAT	HAKA	173.6
493	ISAK	RAMADAN	NELA	189.6
494	Motrat e Cenakullit Domenikan			1174
495	HANE	ISMAIL	TEFERICI	366
496	LUAN	ISMAIL	XHIHANI	78.6
497	YLLI	ISUF	DUPI	481.4
498	GERTI	IBRAHIM	MULLA-ALIU	181.3
499	ANDON	QENDRO	SIMAKU	328.3
500	BUKURJE	RAKIP	SPANJOLLI	283.4
501	DHURATA	QERIM	SKUQI	391.2
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8552, ZVRPP KAVAJE</b>				
502	HAMD	YMER	XHABERAMI	591
503	ZYLFI	OSMAN	HAREM	347
504	FATMIR	MEHMET	SHIMA	233
505	FLORENC	BASHKIM	XHIHANI	401.4
506	BESNIK	DAUT	ISTREFI	401.3
507	EDMOND	YMER	KODRA	339
508	BESIM	OSMAN	ARKAXHIU	19.3
509	XHEVAT	BESIM	HASALLIU	334.5
510	ARBEN	LATIF	GOSA	376.5
511	MARJUS	FLAMUR	BIZHUTA	92.4
512	HILMI	NUREDIN	SHEHI	294
513	SOKOL	HALIT	RROCI	283.3
514	ARTUR	HAJDAR	BEU	213
515	AGRON	GANI	RRUSHI	283.2
516	ALLAMAN	HASAN	VOGLI	151
517	IZET	TAHIR	POPA	237
518	SHPETIM	DEMIR	GJECJA	338.3
519	EQEREM	RAGIP	NASUFI	500
520	KLEJDI	HASAN	PEQINI	128.9
521	BEQIR	QEMAL	BABAMUSTA	427.5
522	AGRON	SHEFER	ZENELI	337.5
523	NEXHMJE	SHABAN	GOSENI	130
<b>DREJTORIA E ALIUZNI-1 DURRES</b>				
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8518, ZVRPP DURRES</b>				
524	ARLINDO	MENTOR	KUÇI	146
525	HALIL	ILJAZ	HASANBELLI	864
526	EDMOND	SKENDER	HASANBELLI	1269
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8512, ZVRPP DURRES</b>				
527	NADIRE	MUSTAFA	KOLA	143
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8518, ZVRPP DURRES</b>				
528	KOSTANDIN	VASIL	QESARI	503
528	ARDIT	FATMIR	HALO	
529	MAKBULE	HAJDAR	MUÇA	412
530	SUZANA	HAJDAR	MUÇA	525
531	ARMAND	HALIT	SHEQI	445
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 3385, ZVRPP DURRES</b>				
532	PETRIT	AZEM	GJONI	305
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 3542, ZVRPP DURRES</b>				
533	LUAN	KASO	GOSTINISHTI	260
533	BARDHYL	KASO	GOSTINISHTI	

534	ARBEN	HAKI	KECI	239
535	ALMA	XHEVDET	KECI	461
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8511, ZVRPP DURRES</b>				
536	BARDHUL	PELIVAN	KUSHOVA	38
	MINEKO	NAZIF	KUSHOVA	
	ARLA	BARDHUL	KUSHOVA	
	HATUJE	BILAL	MALAJ	
	ISMET	QANI	HAJRO	
BEDRI	MEMET	META		
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 8515, ZVRPP DURRES</b>				
537	URIM	SULEJMAN	TACI	265
538	URIM	SULEJMAN	TACI	600
<b>QARKU DURRES, ZONA KADASTRALE 2585, ZVRPP DURRES</b>				
539	ADRIAN	XHOVAN	DOMI	562
<b>DREJTORIA E ALIUZNI-1 KORÇE</b>				
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 8563</b>				
540	NASI	RIZA	VELI	170
541	Luan	Nevrus	Ramo	233.2
	Zhaneta	Avdyt	Ramo	
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 2573</b>				
542	Nezir	Jaup	Jaupi	371.9
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 8561</b>				
543	MAIK	ARBEN	ILIA	221
544	Marije	Barjam	Sheno	57.2
545	Shpetim	Seladin	Aqolli	59.4
	Eqerem	Seladin	Aqolli	
546	FATOS	JORGO	DAMJANECI	193.2
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADASTRALE 8582</b>				
547	Alket	Mustafa	Lako	236.5
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 8562</b>				
548	REDI	LLAMBI	ORGOCKA	18
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 2573</b>				
549	Irfan	Beshir	Bezhani	200
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADASTRALE 8581</b>				
551	AGRON	MYZEDIN	HIMA	110.9
552	Myfit	Shahin	Hima	67.54
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 8582</b>				
553	Arefi	Feim	Gora	
554	Nasibe	Serjan	Tarelli	39.85
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 8561</b>				
556	Vladimir	Kosta	Kico	426.6
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 8563</b>				
557	Robert	Demir	Mustaka	79
	Violca	Muharrem	Mustaka	
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP KORÇE, ZONA KADASTRALE 2631</b>				
558	Ilija	Sotir	Manika	1327.8
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADASTRALE 3006</b>				
559	Muharem	Halli	Agg	427
<b>QARKU KORÇE, ZVRPP POGRADEC, ZONA KADASTRALE 1298</b>				
560	Bardhyl	Islam	Çami	667.3
<b>DREJTORIA E ALIUZNI-1 ZONAT TURISTIKE</b>				
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8551, ZVRPP KAVAJE, ZONA KADASTRALE 2291</b>				
561	LATIF	MUSTAFA	KUMBARA	170.4
562	Njaz	Ali	Elez	248.2
	Mslime	Shaban	Elez	
563	QERIM	QAZIM	SULA	29.92
	VALJETA	SABRI	SULA	
<b>QARKU TIRANE, ZVRPP KAVAJE, ZONA KADASTRALE 1791</b>				
564	SEFER	SULEJMAN	GJUZI	439.02
	FILE	SULEJMAN	GJUZI	
	HAMD	SEFER	GJUZI	
	LEONARD	SEFER	GJUZI	
565	ADRIANA	NEFAL	LEKA	231.2
<b>DREJTORIA E ALIUZNI-1 SHKODER</b>				
<b>QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8593</b>				
566	GJON	NIKOLLE	GURI	480
567	PRENGE	PJETER	ZEFI	500
568	GASPER	SHTJEFFEN	DINGU	290
569	ALEKS	MARASH	ZEFI	238
570	ALBAN	SHEUQET	AGO	23.6
571	ENDRI	SYRRI	RAMJA	260
572	ENRIK	KOLE	GEQA	119
	TEREZINA	ZEF	GEQA	
<b>QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8597</b>				
573	MARK	MARASH	LAMI	170
<b>QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8594</b>				
575	SHUK	NDOC	RROKU	320
576	FITORE	MARK	RROKU	75
	ARTAN	XHEVDET	BRAHIMI	
<b>QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8591</b>				
577	SELIM	HASAN	KRAJA	489.2
<b>QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8592</b>				
579	ASTRIT	MAHIR	GJYREZI	59
580	PAULIN	LUCE	NIKA	311.5
581	BLERIM	MYFTAR	ALUA	485
582	FATMIR	BAJRAM	TAIPI	343
583	MYFTI	BEQIR	META	205
584	HAXHIRE	RIZA	META	178.2
585	SABAHETE	LATIF	META	255
586	ISA	BEQIR	META	500
	HAJRUE	BEQIR	META	
	LUAN	BEQIR	META	
	LULZIM	BEQIR	META	
587	ZVHDI	NUT	BEHRI	412
588	FERID	MUHAMET	BOSHITI	16.5
589	REMYZIE	ABDYL	BUSHATI	
589	ARDIT	NAZMI	SOKOLI	74.3
590	ERJON	XHELADIN	COBUJ	309
591	BUJAR	FEHMI	BILALI	37.7
<b>QARKU SHKODER, ZVRPP SHKODER, ZONA KADASTRALE 8591</b>				
592	NUH	ISA	KUKA	225
593	SAMI	NUH	KUKA	108.9
	AVENIR	FAIK	KALAJA	
<b>DREJTORIA E ALIUZNI-1 TIRANA 2</b>				
<b>QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8180, ZVRPP TIRANE</b>				
594	NEZIHA	HALIT	MUÇA	21.20
	MIRVET	KAZAFER	KOÇI	

(vjon)

## "MBRESA PARISIANE"

Miranda Shehu-Xhilaga

# Një histori dashurie nga Luan Rama

*Kur vij në Paris, qëndroj gjithnjë në një nga hotelet sharmante të Montparnasse në mënyrë që të jem afër këtyre relikeve të famshme...*

Një ditë të zakonshme pune po lexoja diçka në lidhje me profesionin tim, kur papritur kolegu im, që sapo ishte kthyer nga pushimet, futi kokën në derë dhe më pyeti: - Ty të pëlqen Parisi apo jo? Ngrita sytë dhe duke kuptuar që biseda ishte sjellë rreth Parisit mes kolegësh për disa minuta, duke buzëqeshur ia ktheva me pyetje: - Po ty? - Ah, sikur të mund të shkoja dy herë në vit! Nuk do t'i shmangesha aspak udhëtim-it prej 22 orësh, - ma ktheu ai.

John jeton në periferi të Melbourne. Australia ka magjinë e vet, Melbourne është një nga qytetet më të bukura metropolitane të botës por, natyrisht, John ka rënë në dashuri me Parisin!

E kush nuk e vizitoi Parisin e nuk u dashurua me të! Në librin e tij "Paris gjer në Hënë", autori amerikan Adam Gopnick, do të shkruante: "Kam dashur të jetoj në Paris që kur isha 8 vjeç. Kisha shumë imazhe të atij qyteti në kokë, madje edhe një objekt që më vonë u bë një ikonë e dhomës time..." Fjalë që mund t'i kishte shkruar secili prej nesh. I kishim të gjithë në kokë imazhet e qytetit të dritave, të urave, të autorëve tanë të zemrës e të dashurisë. Si Gopnick, edhe unë kisha një objekt të thjeshtë në një nga sirtaret e komodinës së vjetër: një kartolinë që kishte udhëtar nga Parisi në Peshkopi në vitin 1976. Ajo mbartte vlerën e një thesari të vërtetë, një shkëndijë që ndezi ëndrën. Historia ime e dashurisë me Parisin ka filluar herët, që në ditët kur mësonim frëngjisht në qytetin e vogël verior. Orët tona të mësimi ishin kthyer tashmë në leksione magjepsëse rreth një qyteti për të cilin kishim lexuar vetëm në libra. Përpinim me sy çdo fjalë që dilte nga goja e mësuesit tonë të ri dhe imagjinonim sikur ishim atje. Do ta vizitoja Parisin për herë të parë në fillim të vitit 1993, gjatë kohës që ndiqja studimet pasuniversitare në jug të Francës. Pas tetë orësh rrugë me makinë e mbajta frymën aty ku e mbajnë të gjithë turistët e huaj që shkojnë në Paris për herë të parë: në vendin ku të gjithë bëjnë një foto. E vetmja pyetje është në ngjeshë lart në kullë apo ta bësh foton në këmbët e saj. Të dyja? Sigurisht! Për tetë orë të tëra (sepse koha ishte e pakët) iu rashë pash më pash atyre rrugëve, duke vizituar sigurisht Louvre, të parin muze në listën time të gjatë. Më pezmatoi fakti që nuk bëja dot asnjë foto, pasi nuk lejohej, por kjo nuk ma uli dozen e ngazëlimit që provova. Është interesant fakti që isha aty, aq pranë gjithçkaje, e akoma nuk më besohej se këmbët e mia ecnin në rrugët e atij qyteti. Eja në ajër! Dhe në atë çast kuptova përse vizitorë nga e gjithë bota thonë



se kanë një marrëdhënie dashurie me qytetin. Do ta vizitoja përsëri Parisin pesë vjet më vonë, rrugës nga Melbourne në Tiranë. Me mikeshën time të ngushtë Bertlen do të shkonim përsëri në Louvre, do të shëtisnim në "Champs Elysees", do të shkonim në "Musée d'Orsay", do t'u binim gjerë e gjatë rrugëve të Montparnasse e do të provonim të gjitha delikatessat e kuzhinës franceze. Dhjetë vjet më vonë do të punoja për disa muaj në "Institut de Biologie Moléculaire et Cellulaire" në Strasburg e do ta vizitoja përsëri, pothuajse çdo vit, këtë qytet të ëndrrave e dashurive, artit e kulturës, sharmit të pashoq. Por ç'bën një turist në Paris pasi ka vizituar "Tour Eiffel", "Arc de Triomphe", "Musée de Louvre", "Notre Dame de Paris", "Moulin Rouge", "Jardins de Tuileries", "Jardin de Luxembourg", "Musée Rodin" e të tjera, që ka bërë një shëtitje në "Champs Elysees" e një foto tek "Harku i Triumfit"? Ato që në anglisht quhen "land marks" nuk janë veçse "fiziku" i këtij qyteti, kostumi i tij prej cohe të shtrenjtë; ajo çka gjendet nën këtë kostum është një thesar për mendjen e shpirtin, kënaqësinë e syrit e të zemrës, Parisi i vërtetë i kulturës e artit që të sjell përsëri e përsëri aty. Sa më shumë e viziton, aq më shumë dëshiron t'i rikthehesha, e befasisht kupton se një dëshirë e zjarrtë të digjet në gj: të jesh pjesë e këtij qyteti. Magjia ka ndodhur tashmë. E kur kjo

ndodh, si në çdo marrëdhënie, fillon të mendosh për mundësi të tjera për t'u "takuar", gërmon tërëllë në jetën e tij, rrekes të një-hesh më nga afër me të. Rrugët mbajnë emrat e autorëve të zemrës së ditëve të rinisë, në varrezat e famshme prehen titanët e letrave, mendimet e piktorëve. Vetëm në Paris ndodh të shkosh për një vizitë në varreza e të ngazëllesh! Kafenetë gëlojnë nga zërat e piktorëve më të mëdhenj të kohërave, ata janë aty, pas paletave të tyre varur në mure si relike të shtrenjta. Pothuajse çdo gjë është e mundur këtu... Hireve të këtij qyteti iu kanë kënduar të gjithë poetët e botës. Mund të qëndrosh me javë e muaj të tërë aty e çdo ditë të zbulosh diçka të re. Një "bonus" i shtuar është se në Paris jeton një komunitet i shkëlqyer shqiptarësh e mes tyre ca nga miqtë mi më të mirë, të rinj e të vjetër. Është mëkat të vij në Paris e të mos pi një kafe a një gotë verë me Luanin dhe Anilën, të rigjendemi me Aurorën, të qesh me zë me Lirin në një restorant të vogël në një qoshe jo larg "Invalides", të vizitoj Bertlen, Aleksandrin e djemtë, e të pi një kafe "gourmande" me Fulvian. Atë natë të 28 mars të vitit 2017 do të merrja pjesë në mbërmbjen e organizuar enkas për diskutimet rreth librit "Zotërit kishin të drejtë" të Leon Rey ku do të takoja Luan Ramën, djalin e vajzën e arkeologut Rey, Geraldine e Jean-Gabriel, dhe do të tako-

ja arkeologun Etleva Nallbani. Të nesërmen, do të kisha fatin të ecja nëpër rrugicat më të bukura të Parisit për pak kohë me Luanin e të dëgjoja nga goja e tij histori të shumta të poetëve e artistëve më të mëdhenj të kohës që njëherë e një kohë e thërrisnin këtë qytet "shtëpi". Ata aty i kishin mbyllur sytë. Ai i njëj këto rrugë përmendësh, i di historitë e këtyre rrugicave e banorëve të tyre të talentuar me detaje dhe ti e ndjek tek flet me atë zë të qetë, e thua me vete: si ka mundësi që truri i njeriut të mund të strehojë kaq shumë njohuri. Një kujtesë e hekurt!

Nga "Boulevard Saint Germain" vazhdojmë në "Rue de Seine" e pastaj në "Rue des Beaux Arts". Nga "La Palette" tek "Hôtel d'Alsace" ose "L'Hôtel", siç njihet sot, ku kanë jetuar Oscar Wilde dhe Jorge Luis Borges. "Oscar Wilde ka vdekur aty, - thotë Luan, - i pamundur të pagua një dhomë në tij. Kur vinte në Paris, Borges rrinte veçse këtu..." Hymjë në holl ku ai më tregon arkitekturën interesante të këtij hoteli. Personeli i hotelit është mësuar me vizitorët që kalojnë aty pari e fusin kokën të shuajnë kërsërinë. Kafënë e pimë në "Café Procope", që gjendet në rrugën e "Komedisë së Vjetër", kafenaja më e vjetër e Parisit dhe e botës, vend ku takoheshin disa nga filozofët e krijuesit më të mëdhenj të kohës. Edhe Benjamin Franklin e ka frekuentuar këtë kafe, më thotë Luan. Rrugës

për tek "Jardins des Tuileries" apo "Kopshitet e Mbretëreshës", Luan do të më tregonte për fundin e tmerrshëm të Voltaire dhe ndërtesën në të cilën ka vdekur, sesi kisha katolike nuk pranoi ta varroste dhe sesi do të duhej ta vishnin me kostum e ta ulnin në një karrocë si të ishte i gjallë për ta transportuar fshehurazi larg, në një kishë fshati, disa dhjetëra kilometra larg, ku do të kalonte momentet e fundit para varrimit. "Jardins des Tuileries" janë zbuluar me skulpturat e artistit Aristide Maillou, me hirë e modele të tij besnike, Dina, mikja e ngushtë që e shoqëroi gjatë viteve të fundit të jetës së tij; një mrekulli për syrin e shpirtin. Plot 4 orë e 6 km në këmbë! Një ushtrim fizik i këndshëm për trupin! Kur vij në Paris, qëndroj gjithnjë në një nga hotelet sharmante të Montparnasse në mënyrë që të jem afër këtyre relikeve të famshme që jo vetëm i kanë qëndruar kohës, por janë bërë pikëtakimet e dashamirësve parisiane në të gjithë botën. Këtë vit, bëra përsëri turistin e mirëfilltë me sotrat e mia Liden dhe Eden, dhe pastaj vizitova shtëpinë muze të Bourdelle në 18 "Rue Antoine Bourdelle", në Parisin XV si dhe varret e Charles Baudelaire apo Jean Paul Sartre e Simone De Beauvoir. Si grua që jam, gjetja, gjithashtu, pak kohë të vizitoj "Le Grand Musée du Parfum" në "Rue du Faubourg Saint-Honoré", një mrekulli arkitekturale e shë-

ullit të XIX, një eksperiencë e veçantë për shqisën e nuhatjes e shpirtin, një udhëtim interesant përmes historisë e shkencës së krijimit të parfumeve. Preludi i kësaj vizite që mbrëmja e mrekullueshme poetike mes miqsh organizuar nga miksha ime e vjetër Liri. Lili, siç e thërres unë, lexoi edhe një nga poezitë e mia atë natë, një poezi e shkurtër të cilën e kisha shkruar mëngjesin e ditës së parë që u gdhiva në Paris; një mbrëmje që do të mbetet përgjithnjë një kujtim i bukur në kujtesën time, mes vizitave të mia të kaluara e të ardhshme në qytetin tim të zemrës. Në të vërtetë, udhëtimi im i fundit në Paris nuk ishte ky që sapo përmenda më lart, por kur ndër mora të lexoj dorëshkrimin "Mbresa parisiane". Ç'dhuratë e vyer për mua; nga një "dashuruar" me qytetin tek tjetri. Nëse doni të dini për marrëdhëniet e këtij qyteti me njerëzit, kujtimet, baret e famshme madje edhe jetën seksuale, mund të lexoni "Brenda një perle", "Shëtitësi" apo "Parisi ynë, skica kujtimesh" të autorit amerikan Edmund White. Nëse dëshironi të zbuloni marrëdhëniet e këtij qyteti me kulinarinë, lexoni "Jeta e ëmbël në Paris" e David Lebovitz (një nga kuzhinierët më të famshëm, blogger e autor që jeton në Parisin 11), e nëse doni të dini për jetën e përditshme të borgjezisë parisiane drejtohuuni tek "Paris gjer në Hënë", të Adam Gopnik (në 1995, The New Yorker e dërgoi atë me punë në Paris të shkruante për "Paris Journals". Pas kthimit në New York ai do t'i përmbledhte shkrimet e tij rreth jetës në këtë qytet të botës e libri i tij do të ishte "best seller" i vitit). Por, nëse doni të zhytni në pasurinë e vërtetë të këtij qyteti, atë çka ai i ofron shpirtit njerëzor, të ecni në kthinat e qoshet e tij, të përjetoni historinë e marrëdhëniet e tij me figurat letraro-artistike të dy shekujve, si dhe ku kanë lindur disa nga veprat më të lexuara e të cituara në botë, ku kanë lindur e vdekur titanët e mendimit filozofik francez e më gjerë, atëherë merrni në duar "Mbresa parisiane". Është një histori dashurie, një ftesë, një grishje, e cila përmes detajesh marramendëse, forcës, thellësisë e saktësisë së fjalës, përcjell disa nga faktet më të rëndësishme artistike, letrare e kulturore të kohës, copëza të artit e kulturës që gjallon e rreh në zemrën e këtij qyteti. Është një "guide" kulturore e historike, një shëtitje e këndshme, një gosti e bollshme të marra së bashku, servitur me përkushtim e finesë, ashtu siç di vetëm Luan Rama.

Ky libër i vyer e i denjë për çdo bibliotekë, iu bashkëngjitet "Përballë tabloës" dhe "Parisi letrar" të këtij autori, duke formuar kështu një trilogji të përkohër, në gjuhën tonë të bukur. Bon Appetit!



## MJEKU POPULLOR




Ylli Merja: Si të kuroni gjëndrën tiroide me bimë medicinale

## KESHILLA



6 gabimet që nuk duhet t'i bëni pas palestrës

# Albana Duni:

Gastrohepatologia:   
Shkaktarët kryesorë të sëmundjes, kategoritë më të predispozuara



## Si të parandaloni kancerin e stomakut, dieta ushqimore

"Kujdes me ushqimet e tymosura dhe mishin e kuq"

• Pastroni organizmin me çajin e gjetheve. Sallata e ujit, burim i vitaminës C dhe hekurit

**Gastrohepatologia: Shkaktarët kryesorë të sëmundjes, kategoritë më të predispozuara**

# Albana Duni:

## Si të parandaloni kancerin e stomakut, dieta ushqimore

*"Kujdes me ushqimet e tymosura dhe mishin e kuq"*

Voltiza Duro

J o pak pacientë në vendin tonë përballen sot me kancerin e stomakut, i shkaktuar kryesisht nga duhanpirja, konsumimi i tepërt i alkoolit e obeziteti. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjekja gastrohepatologe, Albana Duni tregon se meshkujt janë dy herë më shumë të rishkuar nga sëmundja, e bën me dije se grupmosha më e prekur është 50-60 vjeç, por mund të prekë edhe personat poshtë moshës 40 vjeç. Më tej mjekja thekson se duhen evituar ushqimet e konservuara, të tymosura dhe mishin i kuq, pasi rritin rrezikun e kancerit të stomakut. Gjithashtu, gastrohepatologjia liston të gjitha mënyrat për t'u mbrojtur e thekson se përdorimi i frutave, zarzavateve, ndihmojnë në mbrojtjen e organizmit nga kanceri i stomakut.

### Cfarë e shkakton kancerin e stomakut?

Infeksioni nga Helikobakter Pylori (H P) ku rreth 2/3 e popullsisë në botë është e infektuar me një bakter të tillë, që jeton thellë në palat mukoze të stomakut. Mendohet se ky bakter përhapet nga personi në person, nëpërmjet rrugës fekal-orale, ose nëpërmjet ujit të kontaminuar. Infeksioni nga HP shpesh shfaqet në fëmijëri dhe mund të zgjasë gjatë gjithë jetës në qoftë se nuk trajtohet. Tani infeksioni nga HP është i njohur si shkaku kryesor i ulcerës së stomakut, në rreth 80% të ras-

teve, por mund të jetë shkaku kryesor edhe i kancerit të stomakut. Edhe duhani dhe abuzimi me alkoolin irritojnë stomakun dhe mund të shkaktojnë kancer të pjesës së sipërme të stomakut deri në ezofag. Ndërkohë edhe ushqimet e tymosura, të regjiura dhe mishin i kuq përmbajnë sasi të mëdha nitritesh dhe nitratësh, të cilat në stomakun tonë konvertohen në komponime kancer-shkaktuese. Po kështu një diete me përmbajtje të lartë mishin të kuq (mishi i vicit, lopës, qengjit) sidomos i përdorur si barbecue, ka një lidhje me kancerin e stomakut.

### Cilat janë kategoritë më të predispozuara për tu prekur nga sëmundja?

Seksi mashkull është i rishkuar 2 herë më shumë se seksi femër. Moshë ku evidentohet më shpesh kanceri i stomakut është nga 50-60 vjeç. Por mund të haset edhe nën moshën 40 vjeç. Gjithashtu, edhe burrat që peshojnë 15-20 kg më shumë se pesha ideale, kanë një risk më të madh për t'u prekur nga sëmundja ndërkohë që theksoj se për arsye ende të panjohura personat me grup gjaku A kanë një risk më të madh për kancerin e stomakut. Edhe nëse prindërit kanë vuajtur nga kjo diagnozë, ekziston një risk 2-4 herë më shumë për kancerin e stomakut.

### Pacientët që vuajnë nga ulcera, a janë të rishkuar nga kanceri i stomakut?

Të kesh ulcer nuk je domosdosh-

mërisht para një risku të lartë për kancerin e stomakut, por të kesh infeksionin me Helikobakter Pylori, po.

Mendohet që nivelet e ultra të acidit parandalojnë toksinat kancer-shkaktuese nëpërmjet shkatërrimit të tyre ose nxjerrjes jashtë stomakut. Në stomakun tonë shumë baktere, duke përfshirë edhe HP, konvertojnë nitratet në nitrite, që përdoren në disa ushqime me përmbajtje mishin si hamburger, beikon. Nitritet kombinohen me substanca të tjera që përmbajnë nitrogen duke formuar në stomak N-nitroso-komponimet, që janë karcinogjenë të fuqishëm dhe që njihen si shkaktarë të kancerit të stomakut.

### Cilat janë disa nga simptomat e para të sëmundjes?

Shenja e përbashkët dhe më e hershme e tumoreve malinjë dhe beninjë të stomakut është hemor-



Gastrohepatologjia Albana Duni

ragjia e brendshme mikroskopike, e cila zbulohet vetëm nga testi i feçeve për gjak okult. Në qoftë se hemorragjia vazhdon, me humbje të qelizave të kuqe të gjakut, kjo çon në anemi dhe në shfaqjen e lodhjes.

### Po në rastet kur kanceri është në stad të avancuar, cilat janë shenjat që shfaqin pacientët?

Kur kanceri është shumë i avancuar mund të shfaqen shenja dhe simptoma të tilla si diskomfort në regjionin e sipërm dhe të mesëm të barkut; diskomfort abdominal që agravohet nga ngrënia; jashtëqitje me ngjyrë të zeze; të vjella me gjak; të vjella pas ushqimit; dobësi, këputje dhe humbje peshe; ndjenjë ngopje pas vakteve, megjithëse ngrënia mund të jetë më e pakët se normalisht. Por të kesh një ose disa

nga këto shenja nuk do të thotë se ke kancerin e stomakut. Ka edhe sëmundje të tjera, si ulcera peptike, që mund të shkaktojnë shenja të tilla.

### A është i kurueshëm kanceri i stomakut?

Kanceri i stomakut është i trajtueshëm në qoftë se ai kapet herët. Fatqësisht rrallë simptomat fillojnë në stadin e hershme. Kur shfaqen simptomat, shpesh janë vagale, dhe lehtësisht mund të gabohet për një problem më pak serioz si një virus, ose një refluksi acid. Per të ndihmuar në vënien e diagnozës së kancerit të stomakut dhe për të përjashtuar mundësitë e tij rekomandohen një ose disa nga si:

Fece për gjak okult; endoskopia e sipërme ose gastroskopia; ekzaminimi radiologjik i traktit të sipërm gastro-intestinal. Endoskopia me ultrasund ose EUS ndihmon për të determinuar nëse kanceri ka përhapje në muret e stomakut, ose në indet e afërta dhe nodujt limfatike.

Tomografia e kompjuterizuar ose skaneri përdoret për të kontrolluar përhapjen e kancerit jashtë stomakut sidomos në organe si mëlçia dhe mushkëritë. Rezonanca manjetike shikon përhapjen e kancerit pas stomakut ndërsa ekzaminimi radiologjik i krahavorit sheh nëse kanceri ka përhapje në mushkëri.

### Cila është dieta që duhet rrezikur në mënyrë që të ulët rrezikun e sëmundjes?

Përdorimi i frutave, zarzavateve, sidomos ato me ngjyrë të kuqe ose të verdhe si domatja, karota, patatja e ëmbël, ndihmojnë në mbrojtjen e organizmit nga kanceri i stomakut.



Voltiza Duro

Struma ose gusha quhet sritja dhe zhvillimi i tiroides, e cila mund të jetë difuze ose e lokalizuar në formën e nodujve. Shenjat shfaqen te pacientët në varësi të llojit të strumës. Struma difuze homogjene ku përfshihet sëmundja e basedovit, që prek gratë e karakterizohet nga sekretimi i shtuar i hormoneve tiroidiene T3 dhe T4. Kjo sëmundje është me natyrë autoimmune dhe klinikisht jep disa shenja si: zmadhim i kokërdhokut të syrit (egzoftalmi), e cila është e pranishme zakonisht në të dy dytë. Ndërkohë struma është një masë elastike, shtypet lehtë, zmadhohet lehtë, vjen e vaskularizuar, nuk ka dhimbje dhe gjatë gjëllitjes ka lëvizshmëri e nëse e shikojmë gushën e personave të sëmurë, ajo ngrihet si dy arra dhe ulet poshtë gjatë gjëllitjes dhe nuk shoqërohet me rritje të limfonodujve të qafës. Pra, nuk ka limfonoduj as në gjendje aktive, as në gjendje të fjetur. Gjithashtu, kjo sëmundje jep takikardi të zezrës, që arrijnë deri në 120-130 rrahje brenda 60 sekondash, dhe personat e prekur kanë një oreks të madh por ndodh e kundërta me shtimin në peshë, pasi pavarësisht se konsumojnë shumë ushqim, pesha e tyre trupore bie. Ky grup pacientësh nuk e duron dot nxehtësinë, pra kanë vapë, vishen shumë hollë edhe në dimër, kanë pagjumësi, e nëse janë femra kanë parregullsi në ciklin menstrual, si dhe kanë dridhje durarsh. Nëse kanë dridhje të majave të gishtave dhe përjetojnë disa nga simptomat e sipërpërmendura, duhet të shkojnë të bëjnë një ekzaminim në qendrat e tiroideve. Një grup tjetër njerëzish që mund të vuajnë nga kjo lloj strume, janë edhe ata individë që kanë zbardhje apo dekolim të lëkurës (vitiligo). Të gjitha këto shenja tregojnë që individit është i prekur nga sëmundja e basedovit, që ka një shtim të hormoneve. Të sëmurët duhet të bëjnë analizën e nivelit të jodit T3 dhe T4 dhe TSH. Nëse dalin nivele të rritura të vlerave normale, përveç TSH-së (parametrat e të cilës dalin të ulëta) personi vuan nga basedovi, një nga llojet e strumave. Nëse bëjmë një ekzamin-



Trajtimi me bimë medicinale i basedovit luan një rol tejet të rëndësishëm për efekte të mrekullueshme te pacientët e prekur. Zakonisht kundër nervozizmit dhe ankthit përdoret bima e likopsit, livandoja, bari i bletës dhe qetësuesit e sistemit nervor qendror si borziloku, mendra etj.

Mjeku popullor: Sëmundja e basedovit, simptomat që nuk duhen neglizhuar

## YLLI MERJA: Si të kuroni gjëndrën tiroide me bimë medicinale

"Përbërësit e çajit çudibërës, efektet e menjëhershme"



Mjeku popullor, Ylli Merja

im të tiroideve, ku dallohet qartë madhësia e strumës (gushës) mundet që mos të ketë noduj në brendësi të saj. Mund të vihet re edhe një ngarkesë e jodit, e numri i antikorpave do të dalë më i lartë se zakonisht, çka dëshmon për natyrën e sëmundjes. Edhe sytë e pacientëve do të lotojnë, nuk do të durojnë dot dritën (shenjat më të rënda të sëmundjes)

### Trajtimi me bimë medicinale

Normalisht që trajtimi me bimë medicinale i basedovit luan një rol tejet të rëndësishëm për efekte të



mrekullueshme te pacientët e prekur. Zakonisht kundër nervozizmit dhe ankthit përdoret bima e likopsit, livandoja, bari i bletës dhe qetësuesit e sistemit nervor qendror si borziloku, mendra etj. Në përgjithësi, çaji mund të përgatitet në një litër ujë, duke i përzier bimët e sipërpërmendura së bashku. Ndërsa kur personi ka të dridhura, takikardi, mund të përdoret me shumë rezultat produktet natyrale si: shafra (2 herë, konsumohen 10 fije në ditë); çaj bimor i përbërë nga sherebela dhe rozmarina pasi pakësojnë djersitjen; e për të hequr jodin e tepër në gjak përdorni likopsin. Ndërkohë mund të përdoni edhe një lugë gjelle me livando në çajin tuaj pasi shërben si një qetësues i mrekullueshëm për pacientët e prekur. Nëse pacienti ka edhe noduj të brendshëm, atëherë në brendësi të çajit mund të shtojmë edhe çajin e gjelbër si dhe frutat e shtogut me një lugë gjelle secila. Krahas çajit të mësipërm, personat e sëmurë duhet të përdorin edhe bajamë të egra dhe propolis antimykotik. Ndërsa personat që shfaqin probleme me dritën duhet të përdorin syza mbrojtëse.

**A**nkoheni se lodhjeni shumë në palestër, por prapë nuk po shikoni asnjë ndryshim? Ushqimi juaj si është? Me siguri aty jeni duke gabuar. Të kesh një stil të shëndetshëm jete nuk do të thotë thjesht të stërviteni apo thjesht të hani mirë, por çdo vendim që merrni të jetë rezultat i një zgjedhjeje të mençur. Për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", blogerja healthy lifestyle, çekuella Hasa tregon se cilat janë disa nga gabimet që kurrë nuk duhen bërë pas aktivitetit fizik:

**1. Harroni të hidratoheni**

Shumica e njerëzve jetojnë përreth një dehidratimit kronik. Ju duhet të pini ujë vazhdimisht. Sa shumë? Përafërsisht 30-35 ml për kg peshë trupore në ditë, plus një shtesë 500-1000 ml për çdo orë ushtrimi. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse ju dërsini shumë! Qëndroni të hidratuar para, gjatë dhe sidomos pas stërvitjes tuaj.

**2. Hani ushqime me një "bombë" kalorish**

Ju nuk mund të mbani një dietë të keqe! Të vetmit njerëz që me të vërtetë mund të hanë "çfarë të duan" janë atletët profesionistë. Ata janë duke u stërvitur për orë e orë në ditë dhe kanë një metabolizëm të ndërthurur si një furçe me tuba të nxehtë. Por për pjesën tjetër të njerëzve normale me punë dhe jetë normale ajo që hamë pasi punojmë është me të vërtetë kritike për arritjen e synimeve tona. Jepini trupit tuaj proteina dhe karbohidratet dhe pak yndyrë të shëndetshme në mënyrë që të fillojë riparimin e muskujve tuaj dhe rimbushjen me lëndët ushqyese të humbura sa më shpejt të jetë e mundur. Një vakt i shkëlqyer pas stërvitjes do të ishte një fileto me patate të pjekura të ëmbla. Zgjidhni një nga këto në vend të një burgeri gjigand ose dicka tjetër po aq e rëndë dhe e lartë në yndyrë.

**3. Nuk bëni stretching pas stërvitjes**

Unë e kam thënë dhe e them përsëri, ngrohja juaj dhe ftohja juaj janë pjesë e stërvitjes tuaj. Muskujt tuaj do t'ju përgjigjen shumë më mirë kur t'i trajtoni mirë dhe do të merrni kohë për rikthimin pas stërvitjes. Sidomos kur bëni një stërvitje me intensitet të lartë kjo është një gjë shumë e rëndësishme.

**4. Bëheni "dembelë" gjatë pjesës tjetër të ditës**

Në fakt, kur keni mbaruar palestren ju duket sikur keni hequr dicke "qafe" edhe e keni bërë detyrën tuaj. Edhe gjatë pjesës tjetër të ditës bëheni përtacë duke pasur një jetë jo shumë aktive. Çohuni çdo 1 orë në punë nëse rriini shumë kohë ulur. Çohuni dhe pini 1 gotë ujë. Çohuni bisedoni me një koleg mos i dërgoni email. Përdorni shkallët dhe jo ash-

# 6 gabimet që nuk duhet t'i bëni pas palestrës



ensorin. Bëni punë shtëpie, kjo vlen për femrat, edhe ato janë një aktivitet fizik më vete. Stili jetës ka shumë rëndësi, mundohuni të lëvizni sa më shumë.

**5. Nuk konsumoni ushqim pas stërvitjes**

Jeni në dilemë nëse duhet të hani pas aktivitetit fizik? Mendoni që nëse hani do ju shkojë i gjithë munda i kot? Në fakt, i gjithë sekreti qën-

dron tek ushqimet që zgjedhim të konsumojmë pas stërvitjes dhe koha kur i konsumojmë. Ushqimi është burim lëndësh ushqyese për trupin tonë, dhe si të tilla këto lëndë do të restaurojnë glikogjenin e muskujve, që do të thotë rigjenerim. Nëse keni qëllim të shtoni masë, të humbisni peshë apo të mbani peshën që keni, ushqimi do ju ndihmojë të arrini

qëllimin tuaj. Por nëse hani një picë pas stërvitjes nuk keni për të humbur asnjë gram nga peshja juaj

**6. Gaboni me kohën e vaktit pas palestrës**

Koha është vendimtare për rigjenerimin e muskujve. Prandaj vaktet pas stërvitjes duhet të konsumohen 30 minuta deri në 60 minuta pas aktivitetit. Ky është itinerari që muskujt janë në pozita për të përtihitur më mirë ushqyesit. Nëse hani më vonë ushqimi do të ketë disponiza të shtohet si dhjam.

**Kombinime të shëndetshme që mund të hamë pas stërvitjes**

**Banane edhe gjalpë kikiriku**  
Nëse jeni të uritur pas stërvitjes provoni të hani një banane me 1 ose 2 lugë gjalpë kikiriku. Por mundohuni të zgjidhni gjalpë të pastër pa shitesha sheqeri ose nga vaji i palmës. Bananet ju japin karbohidratet e cilat janë shumë të rëndësishme për shërimin pas stërvitjes. Ndërsa gjalpë kikiriku do ju furnizojë me proteina dhe yndyra esenciale.

**Patate e ëmbël e pjekur dhe vezë**

Një kombinim perfekt nëse doni një vakt të shëndetshme, por edhe të pasur me proteina. Patatja e ëmbël ndoshta do ju marrë pak kohë në përgatitje, por është një vakt me vlera biologjike. Kjo do të thotë se sa gram proteina prodhohen në trupin tuaj në një vakt të shëndetshme, por edhe të pasur me proteina. Patatja e ëmbël ndoshta do ju marrë pak kohë në përgatitje, por është një vakt me vlera biologjike. Kjo do të thotë se sa gram proteina prodhohen në trupin tuaj në një vakt të shëndetshme, por edhe të pasur me proteina. Patatja e ëmbël ndoshta do ju marrë pak kohë në përgatitje, por është një vakt me vlera biologjike. Kjo do të thotë se sa gram proteina prodhohen në trupin tuaj në një vakt të shëndetshme, por edhe të pasur me proteina.

gjitha, prandaj vlera biologjike është e rëndësishme.

**Mollë jeshile me qumësht pa yndyrë**

Nëpërmjet qumështit do të merrni proteinat e duhura pas stërvitjes në formë të lëngshme dhe në formë natyrale. Molla si nga frutat e pasura me fibra dhe antioksidantë do ju ndihmojë të ndjeheni të ngopur. Mollët mund t'i përdorni edhe para se të stërviteni, ato ndihmojnë shumë në cilësinë e ushtrimeve dhe qarkullimin e oksigjenit në mushkuri.

**Kos grek me lulështrydhe**

Kosi grek ka një përbajtje të lartë të proteinave: Një enë (200 gram) përmban 10 deri në 15 gram të makronutrientit. Mjedra, lulështrydhe dhe boronica (të freskëta ose të ngrira) kanë pak kalori, pak karbohidrate dhe janë të pasura me antioksidantë. Në mungesë të kosit grek mund të përdorni kos të zakonshëm por pa yndyrë.

**Sallatë Quinoa**

Një sallatë quinoa e përzier, është një vakt i shijshëm pas stërvitjes. Quinoa është një burim vegan i proteinave. 100 gram quinoa përmban pothuajse 15 gram proteina. Mund t'i shtoni disa fasule ose disa disa perime.

**Smoothie**

Një smoothie me banane, gjalpë kikiriku, qumësht, pak vanilje është një pije që do ju shijojë pas stërvitjes por edhe do ju furnizojë me proteina në mënyrë natyrale.





# Këshilla

## Pastroni organizmin me çajin e gjetheve të bajames

**B**ajamet janë ndër arrorët më të preferuar nga njerëzit dhe përdoren së tepërmi e madje kombinohen më së miri me mjaltnin dhe ofrojnë një ëmbëlsirë delikate dhe të shijshme. Por, vlerat e bajameve mund t'i shijojmë edhe si çaj duke shfrytëzuar gjethet e pemës, pasi ky lëng është ndër më të pasurit me antioksidantë që janë të rëndësishëm kundër qelizave të dëmshme dhe mikrobeve. Antioksidantët praktikisht shkatërojnë qelizat e dëmshme, luftojnë radikalet e lira dhe parandalojnë zhvillimin e baktereve, mykut dhe viruseve. Çaji i gjetheve të bajameve përmban substanca mirëbërëse siç është fibra që pastron organizmin dhe ndihmon funksionin e zorrëve, ndërsa prania e antioksidantëve ndihmon edhe kundër infeksioneve në stomak. Parazitët mund të jenë të rrezikshëm dhe shfaqen gjithnjë në mungesë të higjienës, por sistemi tretës mund të jetë shëndetplotë nëse pini këtë çaj rregullisht. Antioksidantët tek çaji



janë të rëndësishëm kundër substancave të dëmshme që mund të përthithen nga mëlcja. Sugjerohet që pirja e këtij çaji është e rëndësishme për shëndetin e këtij organi.

Pirja e lëngut nga gjethet e bajames ruan shëndetin e veshkave dhe rregullon nivelin e lëngjeve në trup. Reumatizma shkaktohet nga prania e lëngjeve në gjymtyrë dhe kocka e shkarkimi i tyre ndihmon

në zbutjen e inflamacionit. Ndërkaq, antioksidantët parandalojnë degjenerimin e qelizave dhe indeve dhe luftojnë radikalet e lira që shkaktojnë kaos në organizëm. Në këtë mënyrë lëkura do të ketë një paraqitje më rinore. Por vlen të theksohet se ky çaj nxit pastrimin e veshkave nga toksinat e pirja e tij i ushqen veshkat, i mbrojnë ato dhe të gjithë organizmin.



## Sallata e ujit, burim i vitaminës C dhe hekurit

Sallata e ujit, është një barishte që shpesh anashkalohet edhe pse është pjesë e së njëjtës familje botanike si ajo e lakrës dhe rukolës. Kjo bimë ka pak kalori por përmban një sërë elementësh të shëndetshëm dhe antioksidantë me vlera parandaluese ndaj sëmundjeve. Gjethet dhe kërcelli janë të pasur me disa elementë që parandalojnë formimin e radikaleve të lira në organizëm, ndërsa vitamina K formon dhe forcon kockat dhe kufizon dëmet në tru. Sallata e ujit përmban një sasi të madhe të Vitaminës C, 72% të dozës ditore të rekomanduar dhe 64% të vitaminës A; ku vitamina C ka aftësi fantastike për të luftuar infeksionet, të ftohtin, virozat dhe parandalojë mungesën e hekurit ndërsa vitamina A, që ndryshe njihet si retinol është thelbësore për funksionimin e duhur të sistemit imunitar. Ajo prodhon pigmentet në retinën e syrit, mungesa e së cilave mund të shkaktojë humbje të shikimit në errësirë. Përveç antioksidantëve, kjo barishte përmban edhe mangan dhe kalcium, i nevojshëm për kockat dhe dhëmbë të fortë, ndërkohë që kompleksi i vitaminave B6 ndihmon në ruajtjen e funksioneve të metabolizmit. Ekspertët kanë identifikuar më shumë se 15 vitamina dhe minerale në këtë bimë. Ajo përmban më shumë hekur se spinaqi, më shumë kalcium se qumështi dhe më shumë vitaminë C se portokajtë. Sallata e ujit mund të quhet edhe ushqimi i parë i shpejtë.



Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë vendimeve

Ornela Manjani

# Pronarët në Shkodër, ATP merr në shqyrtim 4400 dosje

*Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit*

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4400 dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Shkodër. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në Agjenci për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

**FORMULARI**

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përkrahur në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

**APLIKIMI**

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

**DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI**

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

**SHKODER**

Nr./Dosjes	Data/Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E Njothur/Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
92	31.08.1994	Malesi e Madhe	Pjeter	Malaj	Mbyllje procedimi		
1452	29.06.2009	Shkoder	Sadete	Rexha			Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
484	26.12.2008	Shkoder	Shkelqim	Vasija			Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
829	30.12.2008	Shkoder	Shkelqim	Vasija			Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
831	30.12.2008	Shkoder	Shkelqim	Vasija			Vendimi nuk ka Rubriken e titullit ekzekutiv
61	10.08.1994	Malesi e Madhe	Fridos	Boriçi	Mbyllje procedimi		
58	08.08.1994	Puke	Pashk	Kola	Mbyllje procedimi		
5	20.09.2004	Puke	Basri	Asllanaj	Mbyllje procedimi		
162	30.09.1993	Shkoder	Asim	Gruda	Mbyllje procedimi		
517	16.01.1994	Shkoder	Pjeter	Gjinaj	Mbyllje procedimi		
12	12.03.1997	Shkoder	Nikolin	Lushi	Mbyllje procedimi		
16	15.02.1998	Shkoder	Dede	Kaci	Mbyllje procedimi		
73	08.02.1994	Malesi e Madhe	Simon	Ivanaj	Mbyllje procedimi		
80	10.09.1993	Shkoder	Jak	Gjonaj	Mbyllje procedimi		
524	03.07.2001	Shkoder	Nimet	Zagani	Mbyllje procedimi		
470	30.09.1996	Shkoder	Kol	Kakarriqi	Mbyllje procedimi		
473	30.09.1996	Shkoder	Fadil	Saraçi	Mbyllje procedimi		
477	30.09.1996	Shkoder	Klaudia	Gargjola	Mbyllje procedimi		
523	03.07.2001	Shkoder	Avdi	Zagni	Mbyllje procedimi		
15	s'ka	Puke	Jaho	Haxhia	Mbyllje procedimi		
42	10.06.1994	Puke	Dila	Ndreu	Mbyllje procedimi		
63	15.08.1994	Puke	Prend	Prela	Mbyllje procedimi		
434	nuk ka	Shkoder	Musa	Ademi	Mbyllje procedimi		Me Urdherin nr. 2910/6, dt. 5.2.2010 të D.Pergj. Eshte urdhebruar mosushttrim iniciative ndaj vendimit te qarkut. .

Nr./Dosjes	Data/Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E Njothur/Mosnjohje M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
388	24.09.2008	Shkoder	Agron	Kelmendi	Ndreqje gabimi dhe pasaktësie të vendimit nr. 227, dt. 26.05.1994 te KKKP.		ka lidhje me dosjen 730 dt. 22.10.1993
878	05.04.1994	Shkoder	Nurije	Hysa	Mbyllje procedimi		
256	09.12.2008	Shkoder	Andrea	Darragati			Mungon rubrika ku shenohet data kur merr forme të prere e vendimi
181	12.09.2008	Shkoder	Musa	Shpuza	1820	472	Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit
140	17.07.2008	Shkoder	Nazmije	Hardolli	410	175	Si pjese integrale e vendimit nr 439, eshte nxjerre urdheri nr. 381/5 dt. 22.03.20101 D. te Pergj te AKKP, per mosushttrim iniciative , e qe zevendeson plotesimin e rubriketitull ekzekutiv.
869	31.03.1994	Shkoder	Arben	Kopliku	Mbyllje procedimi		
456/9	13.12.1993	Shkoder	Ahmet	Anamali	Mbyllje procedimi		
1132	26.08.1994	Shkoder	Remixho	Lecej	Mbyllje procedimi		
1156	26.08.1994	Shkoder	Xhemal	Huti	Mbyllje procedimi		
1164	26.08.1994	Shkoder	Ymer	Dibra	Mbyllje procedimi		
1356	15.08.1994	Shkoder	Zamir	Bala	Mbyllje procedimi		
81	30.08.1994	Malesi e Madhe	Ruzhdi	Rroji	Mbyllje procedimi		
80	30.08.1994	Malesi e Madhe	Hysen	Mustafa	Mbyllje procedimi		
78	30.08.1994	Malesi e Madhe	Ali	Bushati	Mbyllje procedimi		
22	27.09.1996	Malesi e Madhe	Fehmi	Bega	Mbyllje procedimi		
66	25.08.1994	Malesi e Madhe	Abdyll	Boksi	Mbyllje procedimi		
413	25.11.1993	Shkoder	Angjelin	Bazhdari	Mbyllje procedimi		
337	05.11.1993	Shkoder	-	-	Mbyllje procedimi		
84	30.08.1994	Malesi e Madhe	Nik	Pacaj	Mbyllje procedimi		
s' ka	s'ka	Malesi e Madhe	Provincia Franceskana	Shkoder	Mbyllje procedimi		

7	03.11.1993	Puke	Vellezrit Demushi		Mbyllje procedimi			
30	s'ka	Malesi e Madhe	Muhamet	Ulqini	Mbyllje procedimi			
371	13.09.1996	Shkoder	Mark	Lisna	Mbyllje procedimi		Urdheri D. Pergj. Per mosushtim iniciative , nr. 1198/3, dt. 24.06.2008	
296	28.06.1996	Shkoder	Ismet	Bushati	Mbyllje procedimi			
303	28.06.1996	Shkoder	Lutfi	Alibali	Mbyllje procedimi		Ka dale Urdheri nr. 1211/3, dt. 24.06.2008. per Mosushtim iniciative	
19	23.09.1996	Shkoder dhe M. e Madhe	Berhan	Dizdari	Mbyllje procedimi		Ka dale Urdheri nr. 601/16, dt. 17.04.2009. per Mosushtim iniciative.	
26	30.09.1996	Malesi e Madhe	Myzafet	Lezha	Mbyllje procedimi		Ka dale Urdheri nr. 569/2, dt. 13.03.2008. per Mosushtim iniciative.	
24	27.09.1996	Shkoder	Genc	Bushati	Mbyllje procedimi		Ka dale Urdheri nr.2893/3, dt. 04.03.2009 per Mosushtim iniciative.	
161	26.08.2008	Shkoder	Marije ; Margerita	Toska			Vendimit i mungon rubrika ku plotesohen shenimet per titullin ekzekutiv	
121	23.06.2008	Shkoder	Henrieta	Mati			Vendimit i mungon rubrika ku plotesohen shenimet per titullin ekzekutiv	
117	23.06.2008	Malesi e Madhe	Ferdinand	Topalli	400			
105	17.06.2008	Shkoder	Ferdinand	Topalli	45000		vendimi parashikon ne piken 2 te tij qe me privatizimin e obj. shiterore subjektit perfiton kthim fizik te sip. 45 000 m²	
38	13.03.2007	Puke	Kujtim	Masrashi				
98/1	15.06.2009	Shkoder	Angjelin	Pjetri	632		Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
77	10.04.2006	Shkoder	Mark	Matusha	Mosnjohje ( shfuqizuar me v. 638 dt. 21.5.2008 te Akkp.		Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
32	16.04.1994	Malesi e Madhe	Sute	Kukaj	Mbylljen e Procedimit			
35	23.02.1994	Malesi e Madhe	Alfons	Vata	Mbyllje procedimi			
10	28.06.1996	Malesi e Madhe	Seit	Baja	Mbyllje procedimi			
12	29.10.1993	Shkoder	Beqir	Sekja	Mbyllje procedimi			
5	pa date	Malesi e Madhe	Violeta	Hoti	Mbyllje procedimi			
33	17.03.1994	Malesi e Madhe	Ragip	Meta	Mbyllje procedimi			
98	01.06.2006	Shkoder	Gjoke	Toma	Mosnjohje prone			
100	19.06.2006	Shkoder	Lutfije	Cungu	Mosnjohje prone			
10	29.08.2007	Shkoder	Guljem	Serreqi			Mostrajtimi i sip. 13800 m²	
172	28.08.2008	Shkoder	Artan	Kolnikaj	20200	20200		
96	10.09.2003	Malesi e Madhe	Ali	Kulolli	Mbyllje procedimi			
20	24.09.2007	Shkoder	Gjon	Serreqi	Mosnjohje prone			
2	19.02.2007	Shkoder	Gezim	Bushati	1 093			
77	28.09.2007	Shkoder	Gjon	Serreqi	12000	12000		
183	15.09.2008	Shkoder	Blendi	Alushi	422			
185	16.09.2008	Shkoder	Hava	Kottri	6000	6000		
96	29.05.2006	Shkoder	Sami	Anamali	Mosnjohje prone			
1021/1	13.08.2008	Shkoder	Ardian	Hajdari	pezuillim procedimi		me vendimin 798 dt. 15.12.199 te KKKP eshte vendosur kthim i sip 320 m² ne lagj. Vasil Shanto	
604	14.02.1994	Shkoder	Mikel	Muzhani	Mbyllje procedimi		Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
975	15.11.2012	Shkoder	Dede	Kaci			Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
1439	25.06.2009	Shkoder	Antonela	Kçira			Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
730	30.12.2008	Shkoder	Maxhide	Dibra			Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
360	30.04.2009	Shkoder	Avokatura Shtetit				ka lidhje me dosjen 149 dt. 29.5.2008	
552	10.06.2011	Shkoder	Bashkim	Myslia			1) Me V. 1607, dt. 29.11.1996, i eshte njohur Sip. 1 520 m² dhe sip. 6 500 m² dhe i eshte kthyer sip 950 e 620 m² truall. 2) Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit.	
255	09.12.2008	Shkoder	Carla	Meschini		4200	Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
18	21.09.2007	Shkoder	Rasim	Barbullushi	Mosnjohje prone		Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
42	26.09.2007	Shkoder	Zhaneta	Miloti			Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
483	30.06.2009	Shkoder	Vexhi	Bushati	120000	13790	Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit. Nga aktet ne dosje del se ky vendim eshte ankimuar ne AKKP, por dosja nuk eshte bashkuar me dosjen ankimore per te verifikuar me tej.	
175	01.09.2008	Shkoder	Sabahete	Spahiu			Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
106	17.06.2008	Shkoder	Blendi	Alushi	Mosnjohje prone		Nuk eshte plotesuar rubrika e titullit ekzekutiv te vendimit	
205	21.04.1993	Shkoder	Fredinand	Pistulli	38500	38500	Vendimi nu ka harte	
363	10.09.1996	Shkoder	Esat	Bushati	43000	43000	Vendimi nuk ka harte	
364	10.09.1996	Shkoder	Shygyrie	Halluni	39000	39000	Vendimi nuk ka harte	
104	04.04.1996	Shkoder	File	Marashi	13200	13200	„Vendimi nuk ka harte - Ne dosje ka dhe nje vendim nr. 307, dt. 27.7.1995, i cili i njeht me te drejte kompensimi subjektit sip. Prej 4 300 m² toke e tjetresuar ne truall dhe 1 000 m² truall	
428	26.09.1996	Shkoder	Adem	Halili	2400	2400	Vendimi nuk ka harte	
329	28.06.1996	Shkoder	Marije	Hila	15000	15000	Vendimi nuk ka harte	
362	10.09.1996	Shkoder	Vehibe	Kazasi	22000	22000	Vendimi nuk ka harte	
24	06.02.1996	Shkoder	Age	Vjerdha	4666	4666	Vendimi nuk ka harte. Ne dispozitivin e vendimit ka nje gabim, pasi ne piken A te tij shprehet per njohje te sip. 466 m², ndersa llogaritja e shumës per kompensim eshte bere referuar sip. 4 666 m²	
325	28.06.1996	Shkoder	Shpend	Salihaj	20000	20000	Vendimi nuk ka harte	
310	25.06.1996	Shkoder	Zef	Dema	31000	31000	Vendimi nuk ka harte	
248	27.6.1996	Shkoder	Andrea	Martini	2000	2000	Vendimi nuk ka harte	
226	26.06.1996	Shkoder	Muhamet	Lohi	27000	27000	Vendimi nuk ka harte	
234	26.06.1996	Shkoder	Xhabir	Lukaj	30000	30000	Vendimi nuk ka harte	
282	28.06.1996	Shkoder	Gjon	Gjeloshi	20000	20000	Vendimi nuk ka harte	
291	28.06.1996	Shkoder	Bukurije	Kali	60000	60000	Vendimi nuk ka harte	
286	28.06.1996	Shkoder	Viktor	Kumrija	25000	25000	Vendimi nuk ka harte	
88	21.03.1996	Shkoder	Pjerin	Deda	48000	48000	Vendimi nuk ka harte	
266	27.06.1996	Shkoder	Qani	Kalaja	15000	15000	Vendimi nuk ka harte	
134	07.05.1996	Shkoder	Ismail	Kombi	9000	9000	Vendimi nuk ka harte	
289	28.06.1996	Shkoder	Shpetim	Bushati	48000	48000	Vendimi nuk ka harte	
200	24.06.1996	Shkoder	Sanije	Druni	2000	2000	Vendimi nuk ka harte	
27	11.02.1996	Shkoder	Angjelina	Lekovia	20000	20000	Vendimi nuk ka harte	
91	25.03.1996	Shkoder	Riza	Haxhija	45800	45800	Vendimi nuk ka harte	
19	31.01.1996	Shkoder	Maruka	Gjoni	58000	58000	Vendimi nuk ka harte	
222	26.06.1996	Shkoder	Veneranda	Paliku	20000	20000	Vendimi nuk ka harte	
221	26.06.1996	Shkoder	Tonin	Kromiqi	6000	6000	Vendimi nuk ka harte	
217	25.06.1996	Shkoder	Kol	Shiroka	10500	10500	Vendimi nuk ka harte	
218	25.06.1996	Shkoder	Hasan	Radovic	20000	20000	Vendimi nuk ka harte	
216	25.06.1996	Shkoder	Zef	Kiri	23750	23750	Vendimi nuk ka harte	
213	25.06.1996	Shkoder	Ballkiz	Shehi	7500	7500	Vendimi nuk ka harte	
250	27.06.1996	Shkoder	Myfit	Bushati	Rezim Kerkese			
270	28.06.1996	shkoder	Gjovalin	Zeka	Negativ, per mungese dokumentacioni			
318	28.06.1996	Shkoder	Shefik	Bejtija	18900	18900		
209	25.06.1996	Shkoder	Fehmi	Begu	59000	59000		
392	19.09.1996	Shkoder	Zef	Muzhani	68000	68000		
390	18.09.1996	Shkoder	Agim	Neziri	Negativ, per mungese dokumentacioni			
293	28.06.1996	Shkoder	Gezim	Tahiri	34604	34604		
379	16.09.1996	Shkoder	Fahri	Bushati	160750	160750		
391	19.06.1996	Shkoder	Zyhdi	Toska	27000	27000		
146	17.05.1996	Shkoder	Zamir	Gjini	28500	28500		
486	30.09.1996	Shkoder	Ahmet	Nehani	25000	25000		
421	26.09.1996	Shkoder	Marash	Marashi	20000	20000		
436	27.09.1996	Shkoder	Rita	Pistulli	Negativ, per mungese dokumentacioni			
444	27.09.1996	shkoder	Refik	Bakalli	Negativ, per mungese dokumentacioni			
268	28.06.1996	Shkoder	Agim	Miloti	Negativ, per mungese dokumentacioni			
142	13.05.1996	Shkoder	Luigj	Gojci	20000	18000		
292	28.06.1996	Shkoder	Sami	Anamali	Negativ, per mungese dokumentacioni			
356	04.09.1996	Shkoder	Ramadan	Selvia	7500	7500		
301	13.06.2003	Shkoder	Xhevahire	Bekteshi	27905	27905		
170	11.06.1996	Shkoder	Behar	Bushati	18000	18000		
535	05.05.2003	Shkoder	Hasije	Çokaj	6000	6000		
534	05.05.2003	shkoder	Marin	Gjonaj	34000	34000		
419	26.09.1996	Shkoder	Ndue	Pali	8500	7140		
300	28.06.1996	Shkoder	Sadetin	Dragusha	Negativ, per mungese dokumentacioni			
295	28.06.1996	Shkoder	Servete	Lukacki	Negativ, per mungese dokumentacioni			
365	11.09.1996	Shkoder	Sabri	Kisha	18000	18000		
257	27.06.1996	Shkoder	Xhelal	Keli	Negativ, per mungese dokumentacioni			
475	30.09.1996	Shkoder	Esat	Berdica	Negativ, per mungese dokumentacioni			
191	20.06.1996	Shkoder	Renato	Radoja	Negativ, per mungese dokumentacioni			
536	25.05.2003	Shkoder	Isak	Ramadani	157750	157750		

Opinion

i Ditës

Nga Monika Stafa

(Vijon nga faqja e parë)

... është rrënuar krejtësisht? Gruaja e bukur pyeste veten shpëtimin e thumbuara njëkohësisht nëse Ulmi (qytet në Gjermani) ekzistonte akoma apo bombardimet e kishin shkatërruar plotësisht. Kur realiteti zhduket me forcë, ta mendosh më pas është çështje besimi. Filmi "The Reader" më solli këtë pasazh me leximit ndryshe të këtij prodhimi kinematografik, duke më bërë të besoj, në fakt, se i tërë realiteti, çdo moment zhduket, edhe pse fatmirësisht jo gjithmonë me skenografinë e përgjakshme të bombave me fosfor, duke i rrëshqitur kështu shqisave tona derisa nuk mbetet asgjë tjetër veçse të mos besosh se ai ekziston. Një besim i përjetuar, që përëndon pas lëvizjeve të trupit, siguron atë lloj qetësie jetësore që të lejon të përshkoh botën pa e prishur qejfin. Kisha lexuar diku se Konti Helmuth James von Moltke, stërnip i një marshali prusian, i cili mbahej si strateg betejash, besonte ngultas tek Jezu Krishti dhe kur Gjyqi Popullor i Rajhut të Tretë, e dënoi me vdekje për qëndrimin e tij kundër Hitlerit, shkoi drejt ekzekutimit si të pranonte ftesën për një darkë jo të këndshme, por të domosdoshme. Gjermanët janë një popull për të cilët thonë se, ata mendojnë se nuk ia vlen aq besimi tek Zoti sesa tek gjërat e krijuara, që të lejon të lëvizësh mes objekteve që të bindin për realitetin e tyre të padiskutueshëm; si karrigia, kafeja, akullorja apo dhe miqësia. Kush nuk ka besim tek vetja është i humbur, si ai që nga frika se nuk ia del në dashuri, me të vërtetë nuk ia del. Ndaj gruaje tek "The Reader" teksa frymonte nën duhmën e një pylli arratisës, u ndje të shqiptonte nën zë se 'Po', ajo i besonte Ulmit, ndërsa vrapin se ndalte as të mbushej me frymë duke i ikur kështu dhe hapit të përtej telave që sillnin vdekjen automatikisht. Po ç'ishte besimi në këtë rast para një qyteti apo disa të tjerëve që u rrafshuan në Gjermani gjatë L.II.B., nënshtruar një 'hakmarrjeje' politike me një fushatë ushtarake të quajtur "carpet bombing"? Çdo herë që emri i një qyteti na përmentet, ajo çfarë ne sjellim ndërmend ndoshta më shumë se arritjet e tij, sado të mëdha, ato mund të kenë qenë, të tjera ndodhi e bëjnë atë të pavdekshëm e ngadhënjimtarë në sytë e vizitorëve. Ja t'ia nisim me shembujt që na i jep historia; Haga të kujton pagën e stisur mes traktatëve ndërkombehtarë për t'i dhënë fund krimeve të luftës, në fund të shek. të XIX; Hiroshima do të kujtohet gjithmonë për sulmet atomike mbi qytetarët e pafajshëm dhe së fundi edhe Drezdeni, kryeqyteti i Saksonisë. Qyteti i besimit protestant do të kujtohet jo aq për madhësinë e së kaluarës mesjetare sesa për tmerrret që prunë sulmet bombarduese gjatë mesit të shkurtit të vitit 1945. Jo vetëm në këto raste, por në tërësi të gjitha këto simbolika mbeten në vendin e duhur dhe po aq të kuptueshme në thelb, tërheqëse dhe domethënëse njëherësh, e ku secili nga ne e gjen të arsyeshëm identit-

# Drezden, rilindja e një qyteti



fikimin e vet. Megjithatë, i vendosur në pjesën lindore të Gjermanisë për shumë dekada, Drezdeni përfytyrohet si i ruajtur brenda një karantine ideologjike dhe izolimi politik. Por një gjë është e sigurt, se kur viziton Drezdenin e kupton se çfarëdo tiranie t'i jetë imponuar qytetit, virtytet themelore të një shpirti evropian do të ishin rregullat e një udhërrëfyesi ungjillor tek të cilat ky popull do të besonte deri në çastin e fundëm të ringritjes së tij. "Ne na pëlqen të jetojmë këtu", më vjen një zë pas veshit, teksa e kundroj me vëmendje rrugën e shtruar me kallëdrinj deri pa shkuar pranë kishës historike (Frauenkirche) në sheshin e qytetit. Një grup të rinjsh ndoshta ishin organizuar të festonin në mbrëmje teksa ishin shpërndarë me pyetësorë nëpër duar, mbi atë se çfarë i bën banorët e tij të jetojnë në këtë qytet lumor. Në Gjermaninë e bashkuar, nuk ka asnjë qytet tjetër të ndahet në vijë aq simetrike në dy gjysma të tij prej lumit që i rrjedh pranë. Është Elba... po, po, ajo që Noli e citoonte me dhimbje të madhe dëshpërimisht tek vajtonte pranë tij, fatet e Shqipërisë. Ku nuk shkoi dhe ai, mendova një çast dhe gurëz it të vogël në kallëdrinj e rashë me majën e rumbullakët të këpuçës. Nuk mu ndanë bashkëkombësit dhe këtu, shtrëngova dhembët sakaq ndërsa përgjatë bregut jugor të Elbës, shtrihet një prej ansambleve arkitektonike më të bukura në botë.

Skela e madhe ujore në stilitin barok dhe kullat nëpër qytet, po aq majat e katedraleve dhe kupolat që ngrihen pas saj, vazhdojnë ende të përfaqësojnë triumfin më të madh historik të Europës me fenomenin e ringjalljes së qytetit,

ringritjes së tij që prej kohës së pasluftës. Dhe ti e ndjen se si një gjysmë qyteti qëndron ballë gjysmës tjetër të tij, e mangët dhe e paplotë ashtu si në ditën e parë të lindjes së tij. Jugu krejt i shkalluar prej bombardimit ajror të aleatëve atë betejë tre ditore në shkurt të 1945, ndërsa më lart, bregu i tij verior i kapur fort prej thonjve të regjimit komunist deri në rënien e perdes së hekurt, dy gjysma më së fundi bashkë, megjithëse jo njësoj, në një peshë të pabarabartë ngjarshes historike mbi supë ndërsa presin të ardhmen. Drezdeni, ngjan se e ka të pamundur t'i mbyllë derën të kaluarës. Ndohëse historia e tij me lavditë e epokës mbretërore, prosperitetin mesjetar si dhe përcaktimit të tij gjatë shek. të 18-të, si "një Firenze pranë Elbës" u zbehën dhe u harruan për gati gjysmë shekulli të errësirës pas Perdes së Hekurt, imazhi ikonë i qytetit mbetë ende terrori dhe shkatërrimi që sollën nëntë e 13/14 shkurtit të vitit 1945, kur 800 aeroplanë të Komandës së Bombarduesve të Forcave Ajrore Mbretërore u dërguan për të rrafshuar këtë perlë arkitekturore të Gjermanisë. Në një qytet, popullsia e të cilit ishte fryrë me refugjatë nga lufta rreth 40.000 vetë u copëtuan, u asfiksuan apo u dogjën për vdekje në stuhinë e zjarrit të krijuar nga bombardimet. 87 përqind e shtëpive në pjesën e brendshme u shkatërruan ndërsa dhjetëra kisha, spitale dhe shkolla u shkrëtuuan. Ishte një fushatë tërësisht shfarosëse sa u duq aq sa Drezdeni mund të ish përkulur përgjithmonë, prej peshës së asaj nate të tmerrshme. Më pas zemërimi, pafuqia apo dhe fajësia e huaj kishin vazhduar ta përkëqësonin frymën e qytetit

gjatë regjimit komunist, i cili sundoi në Gjermaninë Lindore po aq gjatë sa në gjithë pjesën tjetër të Europës. Oportunizmi pat nxitur lidhshpin komunist të asaj kohe ta portretizonte qytetin si viktimë të agresionit kapitalist. Paraja ishte e kufizuar dhe nuk u dha asnjëherë mundësia për ta rindërtuar apo restauruar atë plotësisht me lavditë e kaluara. Megjithatë, banorët e Drezdenit, të cilët dallonin për një frymë rebele dhe një mendje të kthjellët mbetën gjithmonë të papërkulur në virtytet e veta ditënjare. Pas ribashkimit të Gjermanisë në vitin 1990, çështja e rindërtimit të Drezdenit u kthye në një casus, në një metaforë simbolike për pajtimin dhe për shërimin plagësh të vjetra. Prej rrënojave të komunizmit dhe barërave të këqija që fshihnin me dashje gjithë madhësinë historike të qytetit gjatë bregut jugor të Elbës u ringritën edhe një herë kishat, teatrot dhe ndërtesat e mëdha publike, gur për gur dhe gdhendje pas gdhendjeje. Ashtu si atëherë, më 4 gusht të vitit 1945, vetëm gjashtë muaj pas rrënimit të tij, çunakët e korit kishtar kishin gjetur forcën nga brendia e shpirtit të tyre, që në një qytet të shkrëtur të këndonin Requiemin rrëqethës, edhe pse gjendeshin pa dirigjentin e tyre të dashur përballë, Fritz Busch, konduktorin e përkushtuar të operës së qytetit, sepse nazistët e kishin dërguar në kampet e vdekjes. Sot i njëjti Requiem performohet çdo 4 gusht, si një ceremonial përkujtimor në nder të viktimave të asaj masakre të pamendueshme.

Gjatë viteve 1950 dhe 1960, Opera dhe Staatskapelle, lulëzuan sërish ndërsa muzetë e qytetit do të ekspozonin thesaret e artit të madh për të cilin qyteti do të bëhej

i famshëm. Kjo ishte, shkruhet në librat historikë dhe e vetmja arsye që rusët u kthyen sërish në sheshin e atij qyteti. Shumë ndërtesa të stilit barok dhe po aq rrugë të kësaj epoke, ranë viktimë e kufizimeve financiare dhe e paragjyqimeve ideologjike, por ishte besimi i thellë i banorëve të Drezdenit në historinë e trashëgimisë së tyre kulturore dhe në të ardhmen e qytetit, ai i cili i mbajti ata denjësisht të papërkulur deri në çastin e dritës. Besoj në Ulmi, erdhi zëri brenda vetes dhe i dhashë të drejtë zonjës, që ikte për t'i shpëtuar vdekjes së sigurt e për t'u ringritur sërish bashkë me qytetin në një të ardhme jo fort të largët. Ata gjithmonë e mbajtën gjallë flakën e lirisë brenda vetes, duke ndezur qirin çdo vit mes grumbullit masiv të rrënojave, ku gjendej dikur Frauenkirche (Kisha e Zonjës Sonë) ose kisha e tyre luterane, konsideruar si një prej shembujve më të jashtëzakonshëm të arkitekturës protestante. Dhe që kur Muri i Berlinit u shemb, rikrijimi i saj drejt një madhësie të lartë i mungonte prej dekadash ka qenë me të vërtetë mahnitës. Ringjallja e këtij qytetërimi kulturor të qytetit, që ndodhi nga pak në kohë që pas viteve '90, duhet të shihet që të besohet. Kush ka ndihmuar në risjelljen e kësaj mrekulie mes qytetarëve të Drezdenit, nuk bëhet fjalë të përmendim se kanë qenë investime qeveritare dhe as buxhetet shtesë dikujtur kësaj ringritjeje të qytetit. British-German Association dhe Dresden Trust, organizata të fuqishme financiare me bazë në Londër u kujdesën që dhe pas viteve të rënies së Murit, të kontribuonin për rindërtimin e Frauenkirche (Kishës Luterane). Aleatët me fushatën e tyre 'carpet bombing', kishin prekur në një faqe historike që ruante një kujtim të fortë mes gjermanëve, triumfit të një lufte që ata kishin bërë për të ç'rrënjësuar sistemin e vjetër kishtar nga sundimi papal. Reformat kishtarë për të cilat ata kishin dhënë gjakun në mbrojtje të një lirie vlerash dhe parimesh, ishin cenuar duke shkatërruar simbolikën e tij, Kishën e Zonjës Sonë, Kishën Luteriane në qendër të qytetit. Por megjithatë ashtu të humbur shqisash në atë betejë të papritur, ata e ndjenë dhimbjen e qytetit të shkatërruar, Drezdenit, dhe vendosën të punojnë sërish me ata që ishin autorët e betejës masakruese, vetëm e për një arsye për të kthyer pajtimin mes popujve apo ca më shumë se aq, për të bashkëjetuar mes një miqësie të sinqertë. Dhe bashkëpunimi e dha frytin e vet të shërimit dhe përmushjes së qëllimit. Është pikërisht ky shpirt i tyre me këto vlera të forta rishpirtëzimi e rilindjeje që ndihmoi në risjelljen e madhësitë së të kaluarës së Drezdenit, vetëm për një arsye; për të mos harruar shkatërrimin që i ndodhi, për ta rrefyer po aq atë histori dhe njëherësh për t'u frymëzuar prej saj, si një vepër krijimtarie me qëllimin për ta lartësuar atë që ndodhi fizik, social dhe kulturor me hapat e njëllojtë të kohës, e cila shkon vetëm përpara. Historia e rindërtimit të Drezdenit është një histori aritjesh artistike, një histori ku triumfon kurajoja njëherëzore dhe përkushtimi ndaj vlerave, puna këmbëngulëse për ta parë qytetin drejt ringjalljes së tij, ashtu si dikur historianët e për-

Dje/në 'Deutsche Welle'

Nga Henrik Böhme

(Vijon nga faqja e parë)

# Trump kundër të gjithëve, të gjithë kundër Trumpit?

Fillo! Ajo që prfllitej kaq shumë, lufta tregtare. Një gjë dihet shumë qartë: Donald Trump nuk do të lëshojë pe. Kundërshtarët e tij duhet të bashkohen. Por pikërisht për këtë nuk ka gjasa, mendon Henrik Böhme.



...të cituara nga revista gjermane "Java ekonomike" i mvishet Donald Trumpit, atëherë edhe më i fundit duhet ta kuptojë: Ky burrë i shkollon gjërave deri në fund. Ai kapet me të gjithë dhe këdo. Në vatrat e krizës sot në botë, Lindje e Afert, Siri, Iran, Koreja e Veriut, kudo është prezent Donald Trump. Për të gjitha këto kriza ai ka nevojë për aleatë. Aleatë, të cilët ai i zhgënjën, njëri pas tjetrit.

America first -po bëhet gjithnjë e më shumë America alone -America vetëm

Por të kthehemi tek lufta tregtare. Se gjithnjë e kemi parandierë: Autotjetet Mercedes në Fifth Avenue në Nju Jork përbëjnë vërtet një rrezik për sigurinë kombëtare të Shteteve të Bashkuara. Edhe pse ministri amerikan i Tregtisë, Wilbur Ross ka disa javë për ta verifikuar këtë. Ai do të vijë saktësisht tek ky rezultat. Rrezik sigurie, sepse edhe çeliku dhe alumini i importuar nga Europa është një rrezik i tillë sigurie për SHBA. Ndryshe Donald Trumpi nuk mund të vendosë kaq lehtë dogana ndëshkuese, pa pyetur kongresin amerikan.

Por të pyesim seriozisht: nëse qytetarët amerikanë duan të ngasin mercedes, Porsche apo Audi... çfarë do të bëjë Donald Trump, do t'ua ndalë këtë? E nëse europianët i ulin doganat për importet e automjeteve amerikane (që realisht janë më të larta se ato amerikane), por njerëzit në Europë prapë nuk duan t'i bëjnë makinat gjigande amerikane? Çfarë bëhet në këtë rast?

Lejohet të hyjë në SHBA kush ka një shënim në pasaportë - nget Chevrolet? E tani që në Gjermani debatohet kaq shumë për ndalimet e motorëve me naftë, ndoshta një ide për të zbutur Donald Trumpin - një ndalesë për Mercedes në Fifth Avenue?

Ende situata nuk ka dalë nga dora Natyrisht që shqetësimi është i madh, sepse amerikanët e kanë seriozisht. Po bëhen paralajmërimet, shigjetime, por të gjithë e dinë se ç'do të ndodhë pas kësaj. Le të ndjekim rendin e gjërave: dogana ndëshkuese për çelikon europian, kjo nuk është ndonjë gjë e re. Këtë u përpoq ta fuste edhe George Bush

në fillim të mijvjeçarit, dhe dështoi keqazi. E për shkak se është krijuar përshtypja, se po paralizohet tregtia transatlantike, duhet thënë një fakt: për momentin bëhet fjalë vetëm për 1.5% të vëllimit tregtar mes Europës dhe SHBA-së. Reagimet e para nga prodhuesit e çelikut të tregojnë: gjendja është e kontrollueshme edhe me doganat shtesë.

Megjithatë doganat janë realitet dhe europianët po përgatisin kundërgoditjen. Kjo është e rrezikshmja në këtë situatë. Ajo që kemi nevojë janë përgjigje të qarta e pozicione të qarta. Europa duhet të flasë me një zë, por nuk po e bën këtë. Gjigandi eksportues, Gjermania, që preket më shumë, nuk i bëhet vonë për Brukselin, por po ndjek rrugën e vet. Ka jo pak europianë që nuk do të zemërohenin, nëse gjermanët e padashur (ciao Itali, ne ju dëgjojmë) do të merrnin një shuplakë. Kinëzët mund të jenë një partner i ri, por kanë vetë shumë punë me luftën tregtare me amerikanët. Një pasojë mund të jetë: më shumë mallra "made in China" në tregun e hapur europian, sepse Amerika do më pak prej tyre. Çfarë do të bëjë Europa? Dogana më të larta për produktet kinëze? Perspektiva jo optimiste

Sigurisht do të ishte mirë, nëse bashkohen të gjithë ata që vuajnë nën politikën impulsive të presidentit amerikan. Por gjasat nuk duken për këtë. Gjithsekush do të përploqet për vetë të zvogëlojë dëmin sa të mundet. Tani do të ishte ora e Organizatës Botërore të Tregtisë, OBT, por ajo vetë lufton për mbijetesën. OBT është për multilateralizmin, si shumë institucione ndërkombëtare. Trump për të kundërtën dhe rregullat e OBT nuk i interesojnë atij. Për momentin deviza është: sytë mbyllur e përpara. E kur Donald Trump ta ketë mbaruar veprën e tij, të shpresojmë se ka ende aq substancë për të ndërtuar diçka të re.

shkruajnë, një qendër të rëndësishme të kulturës europiane.

Vetëm dy vjet më parë, pasi qyteti përfundoi rindërtimin e tij të plotë që pas shkatërrimit të 'carpet bombing', banorët thonë se ndihen të kënaqur që kjo veprë eci me shpejtësi, ndërsa historia e tij e dhimbshme u bë më shumë e njohur. Frauenkirche, Kisha Luteriane vazhdon të qëndrojë ende po aq e bukur me lavdinë e saj baroke, ndërsa simboli kristian i autoritetit kishtar, Orb-i dhe Kryqi mbi kupolë, na kujton të gjithëve nevojat tona të domosdoshme morale dhe shpirtërore, me të cilat ne duhet ta jetojmë jetën. Ky ishte një projekt i shkëlqyer ku u ndje ideja vizionare e konceptimit të tij, shija e lartë artistike dhe mundësitë

financiare për ta kryer atë. Ishte një sipërmarrje e jashtëzakonshme që plotësoi çdo kërkesë të çdo banori të zakonshëm të Drezdenit për t'u ringritur. Qyteti i Drezdenit ka qenë dhe unik në historinë e tij, me madhësinë e portretit të tij të bukur fizikisht, por unik edhe në arritjet e tij artistike. Jo vetëm, por dhe në fatin e tij tragjik, e më vonë po aq në mbështetjen që u dha për ringjalljen e tij brenda dhe jashtë vendit. Kanë qenë rreth 15-20 grupe biznesesh, të cilat kanë kontribuar në sipër-marrjen e madhe të ringritjes së qytetit dhe rreth tre organizma të mëdhenj financiarë që vinin nga përtej oqeanit. Në mënyrën e vet Drezden Trust mbeti i veçantë, gjithashtu, në ndihmën e tij. Asnjë bamirësi tjetër britanike nuk është fokusuar më

parë specifikisht në një qytet të huaj deri në finalizimin e një qëllimi universal, në këtë rast të pajtimit mes popujve pas një prej tragjediave më të trishtuara të shek. të XX-të. Pas rindërtimit të Drezdenit e të ringjalljes së trashëgimisë kulturore të qytetit, ka gjithmonë një simbolikë të thellë që fshihet në gjurmët e tij. Drezden përfaqëson disa nga elementët më të mirë po aq sa dhe më të tmerrshëm në historinë gjermano-britanike dhe, megjithëse mesazhi i pajtimit të Trust, përbën një rezonancë të veçantë në qytetin vetë, kjo nuk ka të bëjë vetëm me Drezdenin. Kjo ka të bëjë si dhe është parë kudo në Gjermani, Britani apo dhe vende të tjera përtej e këndej kufijve europianë, me aktin special të një miqësie mes popujve dhe të ruajtjes së vlerave të shpirtit europian që popujt e kontinentit duhet të gëzojnë së bashku. Drezdeni nuk është një qytet i cili do të mbahet mend vetëm për historinë e trishtë të shkatërrimit të tij. Ai është një qytet ku ciceronët do të tregojnë nëpër rrjedhat e kohës, histori mbushur me ndodhi këmbënguljeje dhe papërkulshmëri të popullit të këtij qyteti, i cili nuk u dekurrë për ta rindërtuar atë prej fillimit dhe për të krijuar aty një vatër të rëndësishme kulturore për shek. e 21-të. Drezdeni është gjithashtu një përallë e gjatë dhe e bukur, plot me mesazhe miqësie sa i përket marrëdhënieve gjermano-britanike, ashtu si dhe një proverbi gjerman e thotë se gjithmonë kur një mijvjeçar i ri vjen e bën mijësinë gjithnjë e më të vjetër.

## HOROSKOPI

**DASHI**

Keni dëshirë të vendosni një mirëkuptim edhe më të thellë me personin e zemrës, që do t'ju kuptojë menjëherë dhe do t'ju dëgjojë. Keni përkrah një partner vërtet të veçantë! Do të zmadhoni rrethin e të njohurve dhe do të krijoni kontakte të shumta me njerëz të ditur.

**DEMI**

Nëse në të kaluarën janë tërhequr për të qenë vetëm, tashmë keni dëshirë të zbatuani në grup, duke pranuar çfarëdolloj ndryshimi. Ndryshojni pikëpamjet e juaja për t'ju përshatur atyre të partnerit tuaj, nëse nuk janë të njëjta.

**BINJAKET**

Tensionet e lidhura me probleme profesionale do të lehtësohen vetëm nga ëmbëlsia e personit të zemrës, që sot do të jetë më e theksuar. Nuk ndiheni të qetë brenda vetes sepse nuk arrini të zgjidhni midis dy pretendësish që ju kanë magjepsur.

**GAFORJA**

Kini kujdes dhe mos i hidhni shumë bezinje zjarrit të lojërave të pushtetit dhe keqkuptimeve. Jini të drejtëpërdrejtë dhe të sinqertë, dhe do të arrini shpejt të gjitha objektivat që i keni vënë vetes. Kërkoni qartësi në raportet në punë tek kontaktet e reja.

**LUANI**

Më të paqtë a më pak agresiv, edhe pse duhet të qortoni dikë që nuk është shumë i vëmendshëm. Vëreni veten gjithmonë në pozicionin e tjetrit, përpara se ta kritikoni. Në çastin më të posaçëm do të dini gjithmonë t'i rimerrni në dorë frerët e situatës.

**VIRGJERESHA**

Mund të keni ndonjë dhembëq dashurie. Ndoshta duhet të pyesni veten nëse, pak a shumë në mënyrë të pavetëdijshme, nuk jeni ju që i kërkoni shqetësimet... Marsi në bashkëveprim me Venusin do t'ju favorizojë në ndërmarrjen e projekteve të reja. Filloi punën menjëherë.

**PESHORJA**

Një e fshehtë sot, një e fshehtë nesër, rrezikoni të mos mbani më mend se cila është këshillja e fantazisë që keni ndërtuar. Më mirë të ktheheni në realitet! Nëse keni në mendje në lidhje nga e kaluara, mos u angazhoni për të ardhmen, madje as në të tashmen.

**AKREPI**

Një e fshehtë sot, një e fshehtë nesër, rrezikoni të mos mbani më mend se cila është këshillja e fantazisë që keni ndërtuar. Më mirë të ktheheni në realitet! Nëse keni në mendje në lidhje nga e kaluara, mos u angazhoni për të ardhmen, madje as në të tashmen.

**SHIGJETARI**

Për sa u përket ndjenjave, duhet të zgjidhni me zgjuarsi personat që frekuentoni, nëse nuk doni të humbni kohë me lidhje që nuk ju përmbushin. Do të kuptoni se realiteti, të cilit me rastet përiten i shmangeni, është më i mirë sesa ëndërrimi!

**BRICJAPI**

Nëse jeni duke jetuar një histori të bukur dashurie bëni kujdes për të mos komplikuar atë që është e thjeshtë dhe e drejtëpërdrejtë. Kush është beqar ka mundësi të shkëlqyera për një takim të këndshëm. Organizoni një shëtitje në natyrë për të medituar mbi zgjedhjet e juaja më të fundme.

**UJORI**

Urani në bashkëveprim me Saturnin ju mbështet dhe ju dhuron intuitën dhe aftësinë për t'u marrë vesh me të gjithë, edhe me heshtje. Mos merrni përsipër shumë angazhime që e dini se nuk jeni mundësi t'i menaxhoni. Mësoni të thoni jo.

**PESHQIT**

Nuk duhet të ngadalësoni ritmin për të realizuar një projekt me sukses. Ndoshta do t'ju duhet një kohë e gjatë, por ç'rëndësi ka? Jeni në çift. Neptuni do t'ju ndihmojë të stabilizoheni dhe të ndërmerri rrugën e qëndrueshmërisë.

TRAJNERIN NUK E MBAJNË NERVAT



Tifozët e kontestojnë, Panuçi braktis intervistën

Një tjetër humbje e turpshme për Kombëtaren Shqiptare, që është mundur me rezultatin 1-4 ndaj Ukrainës. Kjo ndeshje vinte menjëherë pas performancës së dobët të Shqipërisë ndaj Kosovës, për të treguar më së miri se diçka nuk funksionon në këtë

grup. Kombëtarja është vërshtëlyer në fundin e ndeshjes, ndërsa tifozët kanë thirrur në kor: "luani me zemër!" në momente të ndryshme të lojës. Por momenti kulmor i një pasditeje horror ka ardhur gjatë intervistës së trajnerit Kristian Panuçi. "Duket se fut-

bollistët nuk kanë qenë në kushtet e duhura fizike në këto dy takime, ndaj ishte e pamundur të ndizje zjarin. Nëse nuk je në gjendjen e duhur fizike, nuk mund të vraposh, nuk mund të luash dhe mbi të gjitha nuk mund të punosh. Më falni, sepse duhet të lar-

gohem...", tha trajneri duke u larguar menjëherë nga mikrofon. Tifozët kuqezi kanë vërshtëlyer teknikun italian, duke shprehur haptazi pakënaqësinë që kanë ndaj tij dhe për rënie në piketatë të Kombëtares kuqezi, ndërsa ky i fundit nuk ka duruar më gjatë, duke e braktisur menjëherë intervistën.

Pas dështimit ndaj Kosovës, vjen një tjetër disfatë, Konopljanka dhe Jarmolenko shënojnë nga dy herë

# Kombëtare për faqe të zezë, Ukraina na mund 4-1

Ndoj realizon golin e Flamurit, Panuçi zyrtarisht në krizë

Jeton Selimi

Premtuan se do të na bënim të harronim humbjen e thellë me Kosovën dhe ia dolën mbanë! Shqipëria poshtërohet sërish ndaj Ukrainës sa ajo disfatë me Kosovën duket se i përket një të shkuare të largët. Kjo sepse Kombëtarja kuqezi është një grup i çmontuar! Në pak muaj transformimi negativ i Shqipërisë është aq i prekshëm sa 6 gola e pësuar në 6 ditë, por mbi të gjitha loja skandalozë, me një mbrojtje që fut ujë nga të gjitha anët, me një mesfushë që nuk ndërton asgjë dhe një sulm të izoluar nga rivalët, tregojnë krizën e thellë ku Kombëtarja ka rënë. Ukrainës i janë dashur 14 minuta për ta vënë skuadrën e Panuçit me shpatulla pas murit. Pas disa shkëndijave të vakëta të Lenjanit në minutën e 6-të dhe Mavrajt në të 11-ën, ekipi i drejtuar nga Andriy Shevchenko shpartallon portën e Berishës. Konopljanka çel rezultatin në minutën e 31-të me një të djathtë të saktë nga brenda zonës, ndërsa 5 minuta më pas, Jarmolenko bën çfarë të dojë mes



mbrojtjes inekzistente kuqezi duke i çuar shifrat në 2-0. Por tortura nuk ka mbaruar ende. Në fund të pjesës së parë, Jarmolenko përfiton sërish nga përgjumja e mbrojtjes kuqezi dhe i vetëm përballë Ber-

ishës nuk e ka të vështirë të shënojë. Me rezultati në xhep, Ukraina do të ulë tempin në pjesën e dytë, ndërsa skuadrat do të bëjnë shumë zëvendësime. Në të 68-ën Ukraina do të shënojë golin e katërt, por

Seleznov ishte në pozicion jashtëloje. Ndërsa në të 83-ën është fantastik Etrit Berisha në fluturimin e tij

duke ndalur gjuajtjen e kalibruar të Konopljankës. Në minutën e 88-të Emanuele Ndoj do të ndezë një rreze shprese me golin e tij, por mbrojtja kuqezi do ta fshijë menjëherë edhe këtë moment me një tjetër gafë, që u lejon ukrainasve të realizojnë golin e katërt. Mbyllet 4-1 në Evian të Francës, ndërsa tifozët kuqezi prezent në stadium, nuk ua kursëjnë vërshtëllimat lojtarëve, ndërsa Panuçi, pas përfaqësimit me Shevçekon, merr me vete humbjen e tretë radhazi, ndërsa ndeshjet e radhës janë ato të shtatorit, takimet zyrtare kundër Skocisë dhe Izraelit të vlefshme për Ligën e Kombeve... Panuçi duhet të përveshë mëngët pasi në pak muaj Kombëtarja kuqezi është kthyer aty ku ka qenë 25 vite të shkuara.

FIRMOS ME ISH-EKIPIN



Bledi Shkëmbi merr stolin e Teutës

Përflitej prej ditësh, por dje ka marrë formën zyrtare. Bledi Shkëmbi është emëruar trajneri i ri i Teutës. "Panorama Sport" mëson ekskluzivisht se korçari do të drejtojë durrsakët në sezonin 2018-2019. Pas eksperiencës të Liria e Prizrenit, ish-fantazisti që bëri historinë me Skënderbeun si futbollist, tashmë do të provojë për herë të parë një aventurë në drejtimin e një skuadre të Kategorisë Superiore. Si lojtar Shkëmbi ka veshur gjithashtu, fanellën e Teutës. Shkëmbi ka mbajtur veshur fanellën e durrsakëve në 2 periudha të ndryshme në sezonin 2000-2001 dhe në vitin 2007. Korçari do të rikthehet tani në Durrës si trajner.

VENDIMI

Frika nga ISIS, Ronaldo merr për truporj një toreador

Kristiano Ronaldo na ka mësuar më ekstravaganca nga më të ndryshmet: shtëpi, makina e këshu me radhë. Pa dyshim, edhe me gola të rrallë. Por këtë herë ai i ka surprizuar të gjithë dhe nuk bëhet fjalë për lamtumirën nga Reali. Portugezi ka marrë sërish vëmendje për shkak të truporjës që ka zgjedhur. Nuk ka asgjë të çuditshme të kesh një truporj, por për sigurinë personale në Botërorin e Rusisë Ronaldo ka zgjedhur një torero. Po,

po një toreador! Ai quhet Nuno Marekos. Ylli i Realit e kishte pranë tij për ta mbrojtur në finalen e Championsit në Kiev. Nuno Marekos e ka ndjekur nga afër në çdo hap portugezin dhe do të bëjë të njëjtën gjë edhe në Rusi. Vendimi për të marrë si truporj një njeri të fuqishëm duket se vjen nga ai kërcënim i ISIS-it, i përhapur pak kohë më parë në rrjetet sociale. Marekos e ka bindur Ronaldon për forcën dhe kurajën e tij. Përveçse është marrë me demat, Nuno Marekos ka përvojë edhe në ushtri. Ka qenë



edhe një sportist i MMA dhe të gjitha këto arsye kanë bërë që CR7 të besojë te një toreador.

FIRMINO VULOSI SHIFRAT E TAKIMIT 2-0

Brazili thyen Kroacinë dhe gjen Nejmarin


Brazili ka fituar 2-0 në testin ndaj Kroacisë, por ajo që ka gëzuar më shumë tifozët e seleksionit ishte rithimi në fushë dhe me gol i sulmuesit Nejmar, që u dëmtua në fillim të muajit mars të këtij viti. Futbollisti i Paris Sën Zhërmenit është aktivizuar në pjesën e dytë dhe ka zhbllokuar ndeshjen, e cila në fraksionin e parë

ishte mbyllur me rrjeta të paprekura. Nejmar ka vallëzuar në zonë dhe ka lëshuar një të djathtë të fortë poshtë traversës së Subasiç duke çelur rezultatin në minutën e 69-të. Pas golit të Nejmarit, pati lavdi dhe për sulmuesin e Liverpulit, Roberto Firmino, që në fund të ndeshjes vulosi shifrat 2-0. Brazili është një nga pretendentët për të fituar Kupën e Botës, ndër-



sa trajneri Tite ka në program dhe një miqësore me Austrinë përpara se të ndeshet me Zvicrën në Rusi.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Janë llogari.
8. Kufizojnë një trup.
10. Janë nocionet e para.
13. Janë vendet si Katari.
14. Shkruajnë nga e djathta në të majtë.
16. Një pjese... dardhe.
17. Janë me marka në armatura.
19. Artikull spanjoll.
20. Një pjesë e sadistëve.
22. Janë shemra.
25. Mund të jenë informacioni.
27. Fillojnë javën.
28. Janë gratë në Marrakesh.
30. Janë dhoma.
32. Një Ardiian guvernator i Bankës.
33. Demek s'ka kufij.
35. Janë centralet si Chernobyl.
38. Mbyllin një dyqan.
40. Një impiant hi-fi.

42. Rolet pa re.
44. Një pjesë e parlamentit.
46. Kufizojnë një send.
47. De Fillippi e Amici.
49. Pagëzoi Shen Palin.
52. Ushtrohet një me trysni.
54. Victorien dramaturg.
55. Është edhe ai i Zi.
56. Fillojnë tatëpjetën.

**VERTIKAL**

1. Hunt aktore.
2. Nolde piktor.
3. Gjysmw siklet.
4. Marsi në Areopag.
5. Janë antena satelitore.
6. Rrihet në fund.
7. Pak tebaizëm.
8. Janë taksat.
9. Një test.
10. Ferrara regjisor.
11. Është luftë.
12. Kufizojnë citatet.
15. Një lëndë e organizmit.
16. Qureshin edhe Eumenide.
21. Ai i bardhë është quajtur David Bowie.
23. Është si baba.
24. Julia i Familja Addmas.
26. Jules shkrimtar.
28. Mafia pa zë.
29. Role pa zë.
31. Është zbulurim në skenë.
33. Inicialet e Morricones-s.
34. Irene aktore.
36. Kufij në Oslo.
37. George shkrimtare.
39. U shkrua nga Emile Zola.
41. U shit për një pjatë tjerza.
43. Film shqiptar.
45. Me të nxjerrin trarë.
47. Bega komik.
48. Është yll i skuadrës.
50. Fillojnë ndeshjen.
51. Satelit i Uranit.
52. Inicialet e Dukas kompozitor.
53. Mbarojnë fare.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**

1. Ndan kapitujt
8. Emri i Gonçarov.
12. Është e hollë dhe therëse.
13. Inicialet e Stone regjisor.
14. Është edhe ajo mistral.
15. Kryeqyteti i Marokut.
16. Ki Moon në OKB.
18. Është lloj papagalli.
19. Një pjesë e amerikanëve.
20. Gjysmë tandem.
21. Hapet me trapano.
23. Një sigël maunesh.
24. Ishte djali i Odiseut.
26. Është sherr në shtyp.
27. Artikull spanjoll.
29. Është zog i verdhë.
30. Mund të jetë kuzhine.
31. Inicialet e Lattuada regjisor.
33. Është shtet i papës.
35. Mbeten në fund.


**VERTIKAL**

36. Pesci aktor.
38. Unë dhe ti.
39. Jepet për hartim.
41. Kërkohej nga poeti.
43. Rastisin në krye.
44. Është edhe ai i Kuq.
46. I dha fillin Tezcut.
48. Në krye të armatës.
49. I vetmi në orar.
51. Është ai që premtom të bëhet as.
52. Leblanc që krijoi Arsene Lupin.




7. Triac që qe tenist.
9. Tregohet nga busulla.
10. Kaçaturian kompozitor.
11. Fillojnë natën.
16. Vallëzon me tutu.
17. Janë ata që nuk kanë shumë gjak.
18. Mund të jenë kursimi.
20. Janë katër në violinë.
21. Janë vendet e pazëna.
22. Në mes të Edgar dhe Poe.
24. Janë ato që na përkasin.
25. Këngëtare italiane.
26. Një pjesë e pavijoni.
27. Braktisi Didonën.
28. Mune të jenë lubrifikantë.
32. Lumë në Francë.
34. Kush është... do të pijë.
37. Nolde piktor.
40. Parashtesë zvoqëluese.
42. Zanorë arabe.
43. Rastet pa set.
44. Pak dramatikë.
45. Maket pa kufij.
47. Inicialet e Nolte aktor.
48. Inicialet e Moravia-s.
50. Kështu përfundin një polic.

**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

8								9
	7		2					
	3	9	6	4				
5	8		7					4
				8				
2	4			3				9
8	2					7		4
	9		8					5
7			1	6				

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

8	1	2	9	7	5	6	4	3
6	3	7	4	8	1	2	5	9
9	4	5	6	3	2	7	8	1
5	6	1	7	4	3	8	9	2
7	2	4	1	9	8	5	3	6
3	8	9	2	5	6	4	1	7
1	7	8	3	2	4	9	6	5
2	5	6	8	1	9	3	7	4
4	9	3	5	6	7	1	2	8

*Argëtim filozofik*

- Të jesh me karakter do të thotë, të jesh i drejtë edhe kur s'të sheh njeri.
- Kur ti të fitosh, unë me krenari do i them botës: "Ky është miku im". Por kur të humbasësh, unë do të jem pranë teje duke të shtrënguar dorën dhe të të them: "Unë jam miku yt."
- Jeta është si një libër, varet si e shkruan dhe me çfarë boje...

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

18	3		1	6	9	8	11	8	16	4	8	
18	5	16	4	12	7	3		2		1	14	
8	1	6	5	11	8	8		9	6	1		
3	R	9	5	2	7	3	12	8	9	13	12	
9	K	5	5	2	7	3	1	4	8	15	1	4
		9	6	8	12	8	9	7		6	10	
4	3	5	9	7		8	3	5	12	8	9	7
3		16	1	6	4		7	15	8	4	1	
8	4	1	6	6	1		16	7	7	12	1	
13		6	7			11	1	7		4	1	18
11	1	7		17	7	1	12		6	8	17	1
10	13	4	13	3	8	16	4	7	4		1	3

S	U	P	A		I	K		K	U	R	S	I	
A	P	E	R	A	T	U	R	A				H	K
T	T	O	P	A	T		P	A	P	A	S		
	K	E	M	A	L		T	A	K	A	I		
P	A	R	E	T	I		T	R	U	R	I		
	R	P		I	A	M		E	L	I	A	S	
E	T	A	T		E	T	L	S		H			
P	O	N	Y		E	R	I		I	U	T		
I	L		T	Y	M	I		E	M	K	E		
T	I	R	A	N	E	T		R	I	M	A	T	
E	N		T	I	T	A	N	I	K	E	E		
T	A	U			E	T		K	U	R	A	T	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVË TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

A	R	M	A	N	D		L	I	N	D	A	L	
V	A	J	I	E	M	V	E	K					
A	D	E	N	L	A	K	E	O	A	Z	E		
T	A	K		M	I	L	I	T	A	N	T	E	T
A	P	I	R	A	M	I	D	A	L	E			
R	A	F	T	N	E	R	T	E					
F	A	N	A	T	K	E	T						
D	E	N	A	R	A	E		G	E	G			
E	A	J	E		H	E	R	O	N	J			
M	A	R	I	A	N	A	P	I	N	E	D	A	
E	T	E	R	E	T	I	K	E	T	A	A		
K	A	T	A	R	A	K	T	E	T	A	T	I	M

**FJALËKRYQI (2)**

A	D	A	M	I	R	E	F	O	R	M	A	T	
R	E	K	O	R	D	M	E	N	E	L	A	U	
S	R	T	P	E	K	I	N	M					
N	E	R	O	S	K	A	N	O	T	A	Z	H	I
N	I	R	P	O	L	E	M	I	K	A	T		
E	C	P	E	R	I	M	E	T	E	R			
E	K	R	I	J	I	M	N	A	A	M	E		
E	I	K	M	T	I	N	G	R	I	D			
M	A	T	E	R	I	A	L	I	L	I	G	U	
I	N	A	T	I	R	U	M	O	A	Z			
L	E		G	J	E	N	I	U	N	A			
E	T	E	A	L	T	A	R	E	T	I			

*Argëtim filozofik*

*Thënie të mençura*

- Nuk është e vështirë të ngjitesh në majë. E vështirë është të qëndrosh gjatë atje
- Claude Debussy Kompozitor (1862-1918)
- Disa vese po të përdoren mirë, shkëlqejnë më shumë se virtyti
- La Rochefoucauld Shkrimtar (1613-1680)
- Jeta është si një monedhë! Në njërin anë ndodhet dhimbja dhe në anën tjetër lumturia. Ti mund të shohësh vetëm njërin anë por mos harro, edhe ana tjetër e ka rradhën e saj.

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)

# GAZETA SHQIPTARE

# GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# GSH

[www.gsh.al](http://www.gsh.al)



## Tashmë edhe lundroni!

